



SUPLEMENTI "THASH&THEM" ▶ Faqe 13-17

■ **HADERGJONAJ: JA SI ME NDAU KENGA**
Algen Nikolla: Detajet e dasmës së Valeria Marinitt
■ **REZARTA SHKURTA TREGON BARKUN**
Mirela Milori, lë Zërin e Amerikës për "ABCnews"



Koment
"Amore Grande", Agim Hushi tenori i sfidës

NGA ANILA BASHA

▶ Faqe 21

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi THASH&THEM

VITI III - NR. 109 E shtunë, 11-05-2013



100-VJETORI

Kreu i Dhomës së Avokatëve: Pse u bënë qesharake çështjet "Dajti" e "Shullazi"

DESHTIMI I DREJTËSISË

MAKS HAXHIA: FAJI ESHTË I POLITIKES

Kryeavokati: Situatën ta zgjidhë Ministri i Drejtësisë dhe KLD. Duhet ndryshime në Kodin e procedurës për mos zvarritjen e gjyqeve. Eduard Halimi: Dënim me burg nga 7 deri në 15 vjet për armëmbajtje pa leje, 38 vjet për vrasje ▶ Faqe 2-3

ÇELET SEZONI ▶ Faqe 10-11



Jorgo Goro:
Ja si do t'ju presë Himara këtë verë

TOB ▶ Faqe 20-21

Artistët në fushatë, Ciko-Doko debat me fyerje

NGJARJA ▶ Faqe 4

Shitësi i farave përdhunon gruan e paralizuar

MISTERI ▶ Faqe 6-7



ÇFARË FSHEH ZARFI?!

I dorëzohet Nokës nga Kaç Islami në PD. Flamuri dremit në KRRTSRH

Koment



NGA ARDIAN NDRËCA

Gazi i botës

A e kujtoni skenën makabre të premjes së veshit tek filmi "Reservoir Dogs" të Quentin Tarantino? Diçka e tillë përfytyrohej në mbledhjen hijerandë të komisionit qesharak parlamentar "Veshzhulja e Vjenës" punimet e të cilit sapo u mbajtën në Tiranë.

Komisioni e kreu misionin e tij... ▶ vijon në faqe 12

Koment



NGA AFRIM KRASNËQI

10maj - Dita e Drejtësisë!

Sot në kemi gjykata e prokurori, kemi gjyqtarë të lartë dhe kushtetues, kemi Kolegj Zgjedhor dhe Ministri Drejtësie, kemi KLD dhe Shkollë Magjistrature! I kemi të gjitha, por na mungon ende drejtësia dhe besimi ndaj saj. Disa e gjejmë shkakun tek korrupsioni, të tjerë...

▶ vijon në faqe 12

DOSSIER ▶ Faqe 18-19

PUSHKATIMI I DEPUTETIT TE PARE OPOZITAR

Kolë Prela letër Mehmet Shehut: Ndalo sulmin mbi Dukagjin



NERANXI
... gjithmonë një hap përpara...
Ushqime aziatike dhe meksikane
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 7, Yrshok Tiranë; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com

GRIMCA URBANE ▶ Faqe 12



TIRANA NUK MBAN MË

NGA EVIS CERGA

Moskthimi i të dënuarit, pezullohet drejtori i burgut

FUSHE-KRUJE - Pezullohet nga detyra, drejtori i Burgut të Fushë-Krujës. Vendimi erdhi pas arratisjes së të burgosurit Ilir Avdillari, i cili nuk u kthye në datën e caktuar pas lejes së dhënë. Vendimi për shkarkimin u dha nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Dy ditë më parë, Ilir Avdillari i njohur si një ndër anëtarët e bandës së Yzberishtit, është arratisur

nga burgu i Fushë Krujës. Ai ishte larguar me leje 7 ditore të drejtorisë së burgut por nuk është kthyer brenda afatit të caktuar. Ilir Avdillari duhej të kthehej që dje në Burgun e Fushë-Krujës. 42-vjeçari tashmë është shpallur në kërkim nga policia. 42-vjeçari ishte dënuar me 22 vjet burg dhe i kishin mbetur 3 vjet e 4 muaj për të kryer nga dënimi. Ai dhe vëllezërit e tij, Nazmi

e Fatmir Avdillari ishin anëtarë të bandës famëkeqe të Yzberishtit që veproni në Tiranë në vitet 1997-1998. Ata akuzohen dhe për vrasjen e biznesmenit italian Stefano Rossi, pronari i fabrikës "Niki Shoe". Vrasja u krye më 27 janar '98 në momentin kur Rossi kishte tërhequr 30 milionë lireta nga Banka. Ai u ekzekutua 100 metra larg fabrikës.

Pas dështimit të qindra seancave për dy të pandehurit, flasin avokatët

Dajti-Shullazi, Haxhia: Faji i drejtësisë për avokatët

Ministri Halimi: Armëmbajtja, 7-15 vjet, vrasja nis me 38

Lajmi

Dështimi i seancave në ngarkim të Dritan Dajtit dhe Emiliano Shullazit, ka çuar në reagimin e individëve që merren me drejtësinë. Avokatët thonë, se politikanëve nuk u intereson mbyllja e proceseve, ndërsa ministri Halimi premton, se dënimet do rriten për të gjithë ata që kanë kryer vepra penale dhe janë përsëritës të këtyre veprave

TIRANE

GRANIT SOKOLAJ



Dritan Dajti



Emiliano Shullazi

NË FOTO: Vendi i ngjarjes ku u arrestua Dritan Dajti ku dhe mbetën të vrarë katër oficer të Policisë së Shtetit



Qindra seanca të dështuara për Dritan Dajtin dhe disa seanca të dështuara për Emiliano Shullazin dhe Helidon Harizajt, kanë treguar dështimin e drejtësisë shqiptare. Dritan Dajti akuzohet, se në gushtin e vitit 2009, ekzekutoi katër oficerë policie, të cilët kishin kishin planifikuar një operacion për kapjen e tij. Ndërsa Emiliano Shullazi dhe Helidon Harizajt, të dy me precedentë të mëparshëm penalë, u arrestuan vitin 2011 gjatë një operacioni të for-



Avokati Maks Haxhia

cave RENA në Shëngjin dhe sipas deklaratave paraprake të policisë, ishin të armatosur dhe dyshohet se do të kryenin vrasje.

Avokatët dhe penalistët, e konsiderojnë dështim të strukturave të shtetit shqiptar mënyrën sesi drejtësia po operon në të dy këto procese, kur të dy palët, mos më shumë e mos më pak, shfrytëzojnë "lojërat" sipas tyre me avokatët, për të shtyrë pa fund seancat gjyqësore dhe për të kapur kohën e paraburgimit.

Dritan Dajti, gjykohet në gjykatën e krimeve të Rënda, por e ka kthyer në një "estradë" mediatike procesin e tij gjyqësor. Ndërsa Emiliano Shullazi dhe Helidon Harizajt, pas dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë për armëmbajtje pa leje, kanë filluar të shtyjnë pafund proceset në Gjykatën e Apelit të Shkodrës, duke mos parqitur në proceset gjyqësore asnjë avokat, qoftë ata të miratuar nga vetë klientët, apo ata që janë vendosur kryesisht nga gjykata.

"Duhet të kuptojmë, se avokati i emëruar dhe i vendosur nga vetë klienti, prevalon mbi avokatin e vendosur nga shteti. Kjo është një mënyrë që klientët dhe avokatët e bëjnë mes tyre. Pra nëse gjykata u jep të pandehurve një avokat, këta të fundit, në seancën e radhës kërkojnë avokatin e zgjedhur prej tyre. Avokati i zgjedhur prej tyre, i kërkon gjykatës kohë për t'u njohur me materialet. Gjykata është e detyruar të shtyjë

seancën gjyqësore. Por në seancën e radhës, avokatët, sikurse po ndodh në procesin në ngarkim të Shullazit dhe Harizajt, por edhe në të Dritan Dajtit, paraqesin qoftë edhe raporte mjekësore. Gjykata sërish është e deturuar që të marrë parasysh raportin mjekësor, sipas kodit të procedurës penale, për një proces të rregullt gjyqësor. E në seancën e radhës së vendosur nga gjykata, ky avokat, i vendosur për klientët, jep dorëheqjen nga çështja, duke e lënë

"Duket se klasa politike shqiptare nuk ka vullnet për të zgjidhur këtë problem, pra për ndryshimet që duhet të bëjë në Kodin e Procedurës Penale, ashtu sikurse e bëri këtë në mënyrë të shpejtë me Kodin Penal"

gjykatën me gisht në gojë për të shtyrë seancën dhe të fillojë odisenë me avokatët dhe të pandehurit edhe njëherë nga fillimi", thotë një avokat penalist, i cili sqaron se në çdo moment do të jetë me klientin, përsa kohë në punën e vet është privat.

Argumenti i sjellë për çështjet e bujshme, në fakt të çon në logjikën se Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, qoftë edhe Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë janë përgjegjës për situatën tejte të vështirë në drejtësinë shqiptare dhe konkretisht për dy proceset penale në ngarkim të Dritan

Aurela Anastasi

"Funsionimi i avokatëve të rregullohet me ligj"

Konstitucionalistja Aurela Anastasi, e ftuar dje në televizionin A1 Report, në kuadër të 100-vjetorit të Drejtësisë, është pyetur nga moderatorja Mira Kazhani, edhe në lidhje me zvarritjen pafund të proceseve gjyqësore, për shkak të mungesave të avokatëve. "Në radhë të parë, duhet të procedohet me afatet e njoftimit të avokatëve. Kemi vënë re, se ka shumë afate të shkurtura. Një avokat, me gjithë ngarkesat, ka të drejtën të rregullojë afatet dhe ccështje. Nëse njoftohet 24 orë para seancës, ai s'mundet. Kjo duhet rregulluar në Kodin e Procedurës Penale. Minimumi duhet që mbrojtësit kryesisht të njoftohen 48 orë. Ne e dimë që presione do të ketë ndaj avokatëve, por ligji dhe aktet nënligjore, duhet të jenë të rregulluara. Madje, raste të tilla duhet të na shërbejnë dhe për ndryshime e përmirësime në ligj", ka thënë Anastasi.



Aurela Anastasi

Vrasja e taksistit, prokuroria: 15 vjet burg për komandon

Prokuroria kërkon 15 vjet burg për Aldo Morinën, nënoficerin e Forcave Komando të Ushtrisë, i cili më 1 janar 2013 ekzekutoi me armën e shërbimit, taksistin Mehmet Beqiri. Prokuroria kërkoj dje nga gjykata e Tiranës shpalljen fajtor të Morinës për akuzën e vrasjes me dashje, motivi i së cilës, sipas prokurorisë, ishte lidhja intime që viktimat kishte me të ëmën e Aldos. 53-vjeçari

Mehmet Beqiri u ekzekutua në makinën e tij pasditën e 1 janarit 2013. Nënoficeri u arrestua pak momente pas vrasjes dhe nuk bëri rezistencë. Në ambientet e Drejtorisë së Policisë ku u shoqërua për t'u marrë në pyetje Morina pati pranuar krimin duke deklaruar se e kishte kryer për motive të dobëta. Ngjarja e rëndë ndodhi ditën e parë të vitit 2013 rreth orës 15:30 në kryeqytet. Një

taksist u ekzekutua me tre plumba në kokë, ndërsa policia nisi menjëherë hetimet. Sipas sipas policisë së Tiranës, taksisti 53-vjeçar Mehmet Beqiri është vrarë brenda makinës së tij tip 'Benz' me targë TR 8428 A, nga Aldo Morina, nënoficeri i repartit ushtarak në Zall Herr. Ndërsa pas pak orësh, u vu në pranga dhe autori i ngjarjes, ndërsa policia e lidhi vrasjen me çështje morale.

Reagimi i ministrit

Eduard Halimi reagon për Kodin: Nryshimet tona që ulin kriminalitetit

■ ■ ■ TIRANE

Ministri i Drejtësisë, Eduard Halimi, ka gjetur një formë tjetër, facebook, për të komunikuar për këto shqetësime të rëndësishme të drejtësisë. "Jam plotësisht dakord që kriminelët duhet të marrin të qartë përgjigjen për të gjithë ato jetë që shkatërrojnë tek kryejnë një krim. Kjo është ajo që familjarët e viktimave apo viktimat e dhunës duan të dëgjojnë. Unë jam në krahun e viktimave që ato kanë nevojë të dinë se kur dikush i vret njeriun e familjes, ai do qëndrojë shumë gjatë në burg", shprehet ministri, por pa specifikuar për raste konkrete.

Asnjëherë nuk ka folur ashtu sikurse kërkohej për ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale, për çështjen e avokatëve, por për ndryshimet e reja të kodit Penal po. "Për mbajtjen e armëve pa leje që ligji aktual parashikon gjobë, ne parashikojmë dënim me burg nga 7 deri në 15 vjet. Për vrasjen e policit, gruas apo vrasjen për gjakmarrje ku ligji aktual sanksionin në minimum 20 vjet



Eduard Halimi

burg për autorin, ne parashikojmë 38 vjet në minimum. Të vendosur për tolerancë zero ndaj krimit, të gjitha veprave penale, të përfshira në këtë paketë i kemi rritur si minimumin ashtu edhe maksimumin e dënimt. Mbi 900 raste ka pasur në gjithë Shqipërinë arrestime nga policia për mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe pjesa më e madhe nuk i ishin nënshtruar

burgut! Unë gjykoj se shqetësimi i është i drejtë. Pak kohë më parë, nisur nga një Vendim i Kolegjit Penal Gjykatës së Lartë, i cili kishte deklaruar si në kundërshtim me ligjin një vendim të një gjykate në veri, për lënien e lirë të një personi me precedentë penalë, edhe pse ishte kapur me armë zjarri, inspektimi i gjeti me shkelje këta gjyqtarë dhe me pas ia ka kaluar KLD për të marrë vendim. Por, a mund të zgjidhet kjo vetem me inspektime???? Në mbrojtje të së drejtës së jetës dhe rendit publik duhet të sigurohemi që çdo autor i një krimi të dënohet sa më gjatë, të sigurohemi që ai do ta kryejë ditë më ditë, gjithë dënimin e tij. Ky është angazhimi ynë i vendosur", shprehet ministri Eduard Halimi.

Edhe pse ka angazhime konkrete, duket sikur asgjë nuk ka ndryshuar përse i përket proceseve në terren. Ajo që thuhet me fjalë, nuk zbatohet nga gjykata, ndërkohë që këta të fundit, shpeshherë vihen nën presionin e të pandehurve, (siç ndodhi në rastin kur Dritan Dajti tallej me gjyqtarët në proces). Palët më shumë sesa te reforma në drejtësi, tani e kanë hallin për përgatitjen e zgjedhjeve.

Skepticizmi

Maks Haxhia, kryetar i Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë, i vendosur ditët e fundit në qendër të vëmendjes sidomos për procesin "Dajti", ka një lloj skepticizmi me strukturat shtetërore që mendon se kërkojnë qëllimisht të mos marrin masa për situatën e krijuar

tin. Ai duhet të zgjedhë një ndër avokatët që ta përfaqësojë në gjykatë. Ose ta gjejë këtë avokat edhe vetë, pa kërkuar nga Dhoma e Avokatëve. Në momentin që klienti zgjedh një avokat, çështja është e mbaruar sa i përket mbrojtjes. Atëherë, nëse avokati nuk paraqitet në gjykatë, gjykata e vazhdon procesin edhe pa avokatin, sepse të pandehurit, i është dhënë mundësia e mbrojtjes, dhe ai nuk ka dashur ta shfrytëzojë", sqaron Haxhia rastin konkret, për të shmangur në këtë mënyrë gjithë odisenë e procesit.

Të të njëjtët mendim janë edhe avokatë

të tjerë penalistë, që japin edhe raste të ngjashme në procedurat penale edhe në vende evropiane. Madje përmendet rasti italian i ngjashëm, i diskutuar edhe në Gjykatën e Strasburgut për të mos lejuar proceset që të kenë zgjatje të pafundme të procedurave. "Ndryshimi i Kodit të Procedurës penale duhet të jetë në fokus, pasi si ligji, si konventat e të drejtave të njeriut, garantojnë proceset e rregullta dhe sigurinë e mbrojtjes. Por kjo nuk mund të përligjë në asnjë rast përjashtimet e njëpasnjëshme të mbrojtjes dhe dështimin e seancave gjyqësore. Ligjëvënia duhet të kufizojë ose të heqë mundësinë

e abuzimeve të mbrojtjes dhe të pandehurit të të drejtën e sigurimit të mbrojtjes, pa e cënuar këtë të fundit. Duhet të jemi të qartë, se i pandehuri dhe avokati i tij, duan në rastet konkrete të shfrytëzojnë të gjitha shanset për të mos pasur proces", thotë penalisti.

E në rastin konkret, bazuar në Kodin aktual të Procedurës Penale, Dritan Dajti kërkon që të gjejë shkelje në gjykatë, megjëse ka një akuzë për burgim të përjetshëm, e për të gjetur mundësinë ta çojë çështjen në Strasburg, për të mos përligjur veprimet e ndryshme të parregullta sipas tij në gjykatë.

Ndërsa Emiliano Shullazi, i cili deri më tani, akuzën e ka për një vepër të përsëritur, kërkon që të shtyjë pa fund seancat, duke përfituar nga koha e parburgimit edhe pse në rastin e tij, gjykata ka vendosur të mos e marrë parasysh afatin e parburgimit, pra duke ia stopuar pa limit qënien e tij në burg deri në zhvillimin e procesit.

"Nuk është detyra jonë të zgjidhim këtë situatë. Është detyrë e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët siç bëjnë propozimet për ndryshimin e Kodit Penal, të bëjnë edhe këto ndryshime, në rast se duan dhe kanë vullnet që këto procese të mbyllën. Nuk është detyra jonë të bëjmë këto propozime. Është detyra e shtetit"

e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët siç bëjnë propozimet për ndryshimin e Kodit Penal, të bëjnë edhe këto ndryshime, në rast se duan dhe kanë vullnet që këto procese të mbyllën. Nuk është detyra jonë të bëjmë këto propozime. Është detyra e shtetit. Është halli i drejtësisë shqiptare dhe handikapit i saj dhe jo i klientëve tanë apo i avoketëve. Janë politikanët, që nuk e marrin seriozisht reformën", thotë për shqiptarja.com Maks Haxhia.

"Nuk është detyra jonë të zgjidhim këtë situatë. Është detyrë e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët siç bëjnë propozimet për ndryshimin e Kodit Penal, të bëjnë edhe këto ndryshime, në rast se duan dhe kanë vullnet që këto procese të mbyllën. Nuk është detyra jonë të bëjmë këto propozime. Është detyra e shtetit"

NË FOTO:
Presidenti Bujar Nishani gjatë një mbledhje të KLD-së



← Dajtit dhe Emiliano Shullazit që nuk po shohin ditën e përfundimit.

DHOMA E AVOKATISE

Maks Haxhia, kryetar i Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë, i vendosur ditët e fundit në qendër të vëmendjes sidomos për procesin "Dajti", ka një lloj skepticizmi me strukturat shtetërore që mendon se kërkojnë qëllimisht të mos marrin masa për situatën e krijuar. Madje sipas tij, media nuk duhet të bjerë prehë e sulmit për avokatët, por për shtetin, që nuk dëshiron të marrë asnjë masë për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale që të mund të ndryshojë situatën.

"Avokati ka konfidencë me klientin e tij. Nuk është avokati që duhet të zgjidhë problemin që ka drejtësia shqiptare. Duket se klasa politike shqiptare nuk ka vullnet për të zgjidhur këtë problem, pra për ndryshimet që duhet të bëjë në Kodin e Procedurës Penale, ashtu sikurse e bëri këtë në mënyrë të shpejtë me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë", shpreh skepticizmin e tij Maks Haxhia, kryetar i Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë.

Pyetjes, se si Maks Haxhia mendon se do të zgjidhet odiseja e zgjatjes së proceseve të tilla si e Dajtit dhe Shullazit, për avokatin, ka një përgjigje të thjeshtë, e thënë dhe e përsëritur shpesh nga palët, më së shumti nga Dhoma e Avokatëve, pavarësisht se nuk i intereson kësaj dhome që të merret me reformën në drejtësi, përveçse të japë mendimet e saj konkrete.

"Jepet një listë avokatësh, e vendosim edhe ne në dispozicion këtë listë, për klien-

Korçë, arrestohet 33-vjeçari, marrëdhënie me një 15-vjeçare

Një 33-vjeçar është arrestuar për marrëdhënie seksuale me të mitur, pasi një 15-vjeçare kishte bërë denoncim ndaj tij. Sipas policisë, në pranga ka rënë Emiljan Dine, banues në fshatin Dersnik të Korçës. Në policinë e Korçës, e shoqëruar edhe nga prindrit, është paraqitur 15-vjeçarja K.A., nga fshati Libonik i Korçës. Gjatë kontrollit të

ushtuar nga uniformat blu në banesën e Emiljano Dines, në lagjen numër 10, iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale 60 copë fishekë kalibri 9 mm, 1 silenciator arme zjarri, 1 krehër pistoletë, 2 thika, 6 cope pasqyra automjeti, ndërsa në lokalin në lagjen 9, iu gjetën dhe sekuestruan një sasi prej 15.4 gramë lëndë e dyshuar si "Canabis

sattiva". E mitura që denoncoi, është një 15 vjeçare nga fshati Libonik i Korçës me inicialet K.A. dhe është paraqitur në polici bashkë me prindrit. Personi i arrestuar, është vëllai i kryeplakut të fshatit Dërsnik, Iliaz Dine, i cili rreth dy muaj më parë, qëllimi me armë një efektiv policie, punonjës në doganë, pasi një sherrri për motive të dobëta në një lokal.

Gruaja, një 52-vjeçare, ulej pranë një peshoreje

Shitësi përdhunon gruan e paralizuar

Policia arreston 47-vjeçar in Idriz Murati

Lajmi

Një 47-vjeçar ka abuzuar seksualisht me një grua gjysmë të paralizuar. Policia ka njoftuar, se ka vënë në pranga Idriz Muratin, i cili dy netë më parë, përdhunoi një shitëse ambulante, e paafte për t'u mbrojtur, poshtë urës së Lanës tek "Vasil Shanto".

IRANË

GRANIT SOKOLAJ

Një krim monstruoze ka ndodhur në zonën e shkollës "Vasil Shanto" në Tiranë, ku një person që tregonte paketa cigaresh dhe fara luledielli në trotuarin "Zhan D'ark" ka përdhunuar një 52-vjeçare, me inicialet Mimoza G. Kjo e fundit është e paralizuar dhe se prej disa kohësh dilte në anën tjetër të trotuarit të rrugës "Zhan D'ark", ku qëndronte buzë rrugës me një peshore. Vendi ku ka qëndruar e dëmtuara ka qënë shumë afër me urën mbi lumin Lanë, që ndodhet afër shkollës "Vasil Shanto". Mirëpo teksa ka qëndruar prej disa ditësh pikërisht në këtë kryqëzim, 52-vjeçarja ka mbajtur kontakt me shtetasin Idriz Murati 47-vjeç, i cili qëndronte përballë saj, duke tregtuar pa-



Ura tek "Vasil Shanto" poshtë të cilës ndodhi përdhunimi

keta cigaresh dhe fara luledielli. Gjatë kësaj kohe, 47-vjeçari ka filluar të krijojë simpati për 52-vjeçaren me aftësi të kufizuara, duke vendosur që mbrëmjen e të enjtes të abuzojë seksualisht me të. Sipas hetuesve të komisarit nr.2, të cilët kanë bërë dhe arrestimin e Idriz Murati, ky i fundit ka planifikuar çdo gjë me detaje. Murati ka pritur derisa ka rënë

mbrëmja dhe se në rrugë nuk ka pasur shumë kalimtarë, dhe më pas duke përdorur dhe forcën e ka marrë 52-vjeçaren duke e futur atë poshtë urës së Lanës. Dhe, sipas policisë, pikërisht në këtë vend ka kryer me të marrëdhënie seksuale me dhunë. Pasi ka qëndruar me Mimoza.G, për disa minuta me rradhë, ka vendosur të largohet, duke e lënë këtë të fund

Pedofili

Shtohen pedofilët në Tiranë. Një tjetër rast është regjistruar sot në mbrëmje, kur një 70-vjeçar ka tentuar të përdhunojë një vajzë 10-vjeçare, por është arrestuar nga policia. Sipas burimeve policore, është i moshuari Vasil Zoga ai që ka tentuar të përdhunojë vajzën 10-vjeçare të fqinjët të tij.

it në vendin ku ajo qëndronte si gjithmonë, me një peshore elektronike përpara. Ka qënë ora 21:00, kur 52-vjeçarja me aftësi të kufizuara nuk ka mundur të mbrojë veten duke rënë prehe e sulmit seksual nga një person, të cilin ajo e kishte njohur vetëm pak ditë më parë. Mimoza.G. dhe Idriz Murati kishin vetëm pak ditë që ishin njohur pasi qëndronin përballë në trotuarin e rrugës "Zhan Dark". 52-vjeçarja vinte në atë vend nëpërmjet një karrocce dore, ku hera-herës shoqërohej nga ndonjë i afërm dhe kishte raste që ajo vinte dhe vetëm. Të

njëjtën gjë e bënte dhe në ikje për në shtëpi. Mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur gjatë mbrëmjes së të enjtes, pasi personi që ajo kishte përballë, e ka marrë dhe e ka futur poshtë urës së Lanës, duke abuzuar seksualisht me të. 47-vjeçari Idriz Murati, për të shuar kureshtjen e njerëzve, i ka zënë me duar gojën dhe më pas ka abuzuar me 52-vjeçaren duke e kërcënuar njëherësh se do e mbyste në Lanë, nëse do të tregonte dhe do bërtiste. Sipas policisë së Tiranës, gjithçka ka ndodhur në orët e mbrëmjes dhe në ambient të hapur, ku referuar dëshmitës së 52-vjeçares së dëmtuar, kanë qënë dhe disa persona që kanë qëndruar në trotuar dhe kanë parë se çfarë po ndodhte, por nuk kanë tentuar të shkonin për ndihmë. Kjo, mbase se, sipas policisë, kalimtarët kanë menduar se kishin të bënin me ndonjë prostitutë që lëviz në ato orë të natës. Autori i krimit është larguar më pas, duke kërcënuar të dëmtuarën se nëse tregonte në shtëpi apo në polici, ai do e vriste.

DURRES Verifikimet

Dy persona të shpallur në kërkim arrestohen në port

Dy persona të kërkuar janë kapur nga strukturat policore të Portit të Durrësit gjatë ditës së djeshme, njëri prej të cilëve në kërkim ndërkombëtar për një sërë veprash penale të krimit të organizuar. Në orën 13.00, u bë arrestimi i Franko Murjës, 26 vjeç, banues në Laprakë Tiranë. Personi në fjalë, pas verifikimit të bërë nga shërbimet e Policisë Kufitare në kohën kur po hynte në territorin shqiptar rreth orës 10.30, rezultoi person i shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Firences në Itali ka lëshuar ndaj tij urdhrin e arrestit ndërkom-

bëtar për një sërë veprash penale, si "Traffikim i lëndëve narkotike", "Shfrytëzim prostitucioni", "Pjesëmarrje në organizatë kriminale" dhe "Emigracion i paligjshëm". Policia, nëpërmjet një komunikate për shtyp, nënvizon se, "nga ana jone u bë arrestimi i këtij personi u sekuestruan në cilësinë e provës materiale pasaporta e tij biometrike, si dhe u kryen veprimet tjera".

Ndërkohë, pak orë më pas, shërbimet e Policisë Kufitare evidentuan në hyrje një tjetër person të kërkuar, shtetasin Artor Tahiri, 41 vjeç, banues në Shijak. Ky person është



shpallur në kërkim, pasi Gjykata e Rrethit Durrës, me vendim datë 27.04.2012, e ka dënuar me 15 muaj e 21 ditë burgim për falsifikim. Sektori Kundër Krimit Ekonomik në Drejtorinë e Policisë Qarkut Durrës po vijon kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale ndaj tij.

GREQI Bandat

Përleshje në burg, shqiptarët vrasin me thikë irakianin

Një irakian ka mbetur i vdekur si pasojë e përleshjes së egër midis bandash të burgosurish në burgun e Grevenas në Greqi. Ngjarja u regjistrua në orët e vonshme të pasdites së djeshme, kur një grup të burgosurish shqiptarë, pasi ishin grindur me një grup tjetër të burgosurish nga vendet arabe, vendosën të lajnë hesapet mes tyre, e me këtë rast të burgosurit shqiptarë me një thikë provizore, të kllujr në burg, kanë vrarë një irakian dhe kanë plagosur tre të tjerë. Të plagosurit u transferuan urgjentisht në gjendje të rëndë në spitalin e qytetit të Grevenas, ndërsa forca të shumta policore kanë shkuar në burg, ku po kryejnë kontrolle të imtësishe. Policia nuk ka dhënë ende detaje rreth kësaj ngjarje të rëndë, por kanë bërë me dije se edhe para një jave kishte pasur përleshje të tilla dhe se në atë rast ishin plagosur shtatë të burgosur.



LAJME SHKURT

Fier e Korçë, dy aksidente me 4 të plagosur

Dy aksidente kanë ndodhur pasditen e djeshme, nga ku të lënduarit ndodhën jashtë rrezikut për jetën. Në Fier, në aksin Shën Pjetër – Topojë aksidentohen burrë e grua, teksa kalonin rrugën për të shkuar tek tokat e tyre. Nasi dhe Eleni Llupi janë përplasur nga një automjet, por janë jashtë rrezikut për vdekjen. Ndërsa në Korçë, janë përplasur dy automjete tek Parku Rinia, por drejtuesit ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Policia ka shkuar në vendngjarje për të verifikuar rrethanat.

Tepelenë, njëzetin një sorian i mbytur në Drino

Pasditën e djeshme u gjet në ujërat e lumit Drino një klandestin i mbytur sorian. Kufoma u gjet 170 metra poshtë urës së Leklit në Tepelenë. Ai u gjet nga një peshkar në mes të lumit, ndërsa ai menjëherë ka njoftuar policinë e cila ka bërë nxjenjen e trupit. Mendohet se ai është i moshës 35-vjeçare, klandestin i ardhur nga Greqia. Ai ka kaluar nga Kakavia dhe është hedhur në anën tjetër të lumit për t'iu shmangur postbllokut të policisë. Ndërkohë, mendohet, se e ka marrë rrymën.

Lezhë, zjarri i pestë brenda muajit në banesa

Shkëndijat elektrike në rrjetet e amortizuara të ndërtesave të vjetra, janë shkaktari kryesor i zjarreve në banesa në qytetin e Lezhës. Vetëm brenda një muaji, pesë shtëpi janë djegur nga shkëndijat elektrike. Shërbimi zjarrfikës është i pafuqishëm për parandalimin e këtyre rasteve, ndonëse deri tani ka arritur të ndërhyjë në kohë duke shmangur viktimat në njerëz. Një tjetër problem për shërbimin zjarrfikës të Lezhës janë mjetet logjistike, të cilat janë të amortizuara.

Durrës, arrestohet 29-vjeçari, vodhi 15 çadra

Një 29-vjeçar nga Durrësi akuzohet për vjedhjen e 15 çadrave dhe shezlongeve. Pas denoncimit të rastit të vjedhjes nga pronari i tyre, 29-vjeçari Mario Kapedani është arrestuar nga blutë e Durrësit, pasi dyshohet se i ka shitur ato për skrap në pikat e grumbullimit. Ngjarja e ndodhur në 5 maj të këtij viti, ka bërë që ndaj Mario Kapedanit të fillojë procedimi penal për vjedhje.



Malaj: 3 deputetët në listat e PD, e shoh me dhimbje

Kandidati i Pavarur në Qarkun e Vlorës, Karben Malaj foli edhe njëherë për mospërfshirjen e tij në listat e PS dhe për vendimet që ndërmori më tej. Sipas tij, përjashtimi ka qënë gradual dhe jo një surprizë. Kandidimin e tij si deputet i pavarur, Malaj e sheh si një mundësi për të realizuar rotacionin politik, ndërsa shton se objektiv për të mbetet mundja e Berishës dhe jo thjesht marrja e një

karrigeje në Parlament. Ai nënvizoi se, ish-kreu i PS Fatos Nano ka dhënë kontribut maksimal për demokratizimin e PS. "Rama vazhdon me objektivin si të mundë socialistët brenda socialistëve dhe jo si të mundë Berishën", tha Malaj. Ai shtoi se është i bindur se do të fitojë mandatin e tetë në Vlorë dhe se atë nuk do ta përdorë kundër socialistëve. Në lidhje me përfshirjen e 3 ish-deputetëve të PS-së

Kastriot Islami, Asllan Dogjani dhe Gjovalin Kadilli në listat e PD, Malaj komentoi shkurt. "Përfshirjen e tyre e shoh me dhimbje, por nuk i gjykoj, as i mirëkuptoj", tha Malaj. Ndërsa për mbështetjen e ofruar nga Nano, ai u shpreh krenar. "Mbështetja e zotit Nano erdhi pas kandidimit tim si deputet i pavarur. Është politikani që futi kulturën e dorëzimit paqësor të pushtetit", shtoi ai.

Një ndër të "urtët" pranë Ramës: Listat e PS, më të mira

Brokaj: Tradhëtarët në PD, votat për PS

"Tani jo vërejtje, por të largojmë Berishën"

Lajmi

Një ndër të urtët e PS pranë Ramës, ish-ministri i Mbrojtjes dhe njëri nga drejtuesit e lartë të PS ndër vite, Sabit Brokaj thotë se kandidimi i Islamit, Kadelit e Dogjanit në listat e PS vetëm përfitime i sjell PS, asnjë humbje. Ai kërkon kompaktësi përballë Berishës.

TIRANE

JAKIN MARENA

Ish-drejtuesi i lartë i PS, aktualisht një ndër të "urtët" pranë kreut socialist, Sabit Brokaj thotë se listat e PS janë më të mira se sa të PD. Ai shprehet se kandidimi i 3 deputetëve aktualë të PS në listat e PD dëmton më shumë Berishën, por përfiton Rama.

Fushata ka filluar tashmë. Si e shikoni të majtën e bashkuar?

Vetë të fushata ka filluar me kohë, sepse atë e imponon sjellja e kundërshtarëve të PS. Pra më konkretisht atë e përcakton kreu i mazhorancës Berisha. Ai e ka fushatë tërë jetën, jo qeverisje, duke detyruar kështu kundërshtarët e tij politikë që të jenë tërë jetën në fushatë. Tashmë ajo po merr kontoret e një fushate të rregullt, me ekipe, strategjitë



NË FOTO: Sabit Brokaj

Rotacioni

"Prej këtij momenti, mund të bëhet fjalë vetëm për faktin se nëse Shqipëria do të ecë në procesin demokratik e integruar apo do mbetet në vend. Prandaj nuk ia vlen të merremi me vërejtjet apo diçka tjetër, përballë qëllimit të vetëm madhor dhe kombëtar, largimin e Berishës".

caktojnë përmes disa kriterëve që s'mund t'u shmangesh lehtë, ndryshe dështon. Gjithnjë pika e parë është kontributi politik, personaliteti publik, gjeneratat ose brezat, gjeografia, ndërthurja fetare, etnike etj. Pra janë elementë që shihen një për një, jo pasi i ke trazuar e bërë çorbë. Gjithsesi gjykoj që lista e PS është mjaft më e mirë se sa ajo e PD. Lista e PD është një çorbë derrash që po të shikosh me syrin e një profesionisti në politikë, s'mund të dallos cilin kriter ka ndjekur Berisha përveç atij të një njeriu në panik, përveç kriterëve individual, krahinore apo klanore. Por tani s'është momenti që të

dhe taktikat e shkruara. Nëse flasim me gjuhën e një ushtaraku, tani po bëhet rreshtimi i forcave për t'i hedhur në betejën elektorale. Dhe në këtë betejë ka shumë rëndësi organizimi, kompaktësia dhe koshienca e tyre për të fituar. Organizimi e kompaktësia ka elementë brenda partiakë por dhe koalicionin në vetvete. Gjykoj që,

ndërsa brenda partisë natyrisht për vetë strukturat e organizimit dhe të drejtimit që ka në parti, është më i arrirë, organizimi dhe kompaktësimi në koalicion është në proces, por në drejtimin e duhur pozitiv.

Janë bërë publike listat e kandidatëve, si i shihni ato...?
Unë do kisha vërejtje lidhur

me listën dhe do e filloja nga PS. Mund të ishte shumë më e mirë që kjo. Por ka kohë që kryetarët e partive, politikanët shqiptarë anojmë shumë më tepër nga aspekti individual se sa ai kolegjial, më shumë autoritarist se sa ai demokratik. Harrojnë një gjë: Janë disa elementë që politika si brenda një partie, ashtu dhe një shteti, që i për-

flitet më për kritikë listash, por është momenti që ky grup të jetë sa më i organizuar dhe sa më i përkushtuar, për një fitore sa më të thellë me 23 qershor.

Që do të thotë...?

Pavaresisht vërejtjeve apo diçka tjetër, lufta politike tani ka vetëm një qëllim: largimin e Berishës. Prej këtij momenti, mund të bëhet fjalë vetëm për faktin se nëse Shqipëria do të ecë në procesin demokratik e integruar apo do mbetet në vend. Prandaj nuk ia vlen të merremi me vërejtjet apo diçka tjetër, përballë qëllimit të vetëm madhor dhe kombëtar, largimin e Berishës.

Prishin punë për opozitën kandidatët e pavarur...?

Unë mendoj që prishin punë. Ka një gjë, po të ndjekësh arsyetimin e dy socialistëve që kandidojnë si të tillë, që thonë se sigurojnë votat e plota për të dalë deputetë, mund të themi që aritmetika nuk prishet. Por ekziston rreziku që diferenca me numrat dhe mosmarrja e mandatit prej tyre, të ketë ndonjë pasojë.

Po kandidimi i tre deputetëve të PS në listat e PD...?

Për mua kanë bërë një veprim politik krejtësisht të papranueshëm dhe nuk ia vlen të merresh me ta. Është një gjest jo normal. Mendoj që nga lëvizja e tyre përfiton me shumë PS, se sa PD.

Reagimi, Islami-Dogjani:

"Rama, diversion me ish-deputetët e PS, e ka kapur paniku prej humbjen"

TIRANE

Deputeti socialist, tashmë kandidat për PD, Asllan Dogjani, ka reaguar ndaj deklaratës së kryesocialistit Rama, se deputetët "tradhtarë" i bëjnë mesazhe dhe se do të rikthehen tek PS pas 23 qershorit. Dogjani thotë se Ramën e ka zënë paniku i humbjes dhe bën diversion. "Megjithëse nuk kam kohë të merrem me Edi Ramën për shkak të fushatës elektorale, jam i detyruar për të reaguar ndaj intrigave, diversionit, shpifjeve dhe sulmit të tij ndaj meje dhe deputetëve që janë larguar për shkak të tij nga PS. Unë e kam thënë dhe herë të tjera, që kam patur fatin ta njoh nga afër këtë njeri me dy fytyra, që ndryshe flet dhe ndryshe vepron. Ky njeri me maskë, që për shkak të dëshpërimit dhe panikut



Kastriot Islami



Asllan Dogjani

që e ka mbërthyer për humbjen e radhës, mundohet të bëjë diversion dhe të fitojë me konjuktura e shpifje të ulëta dhe jo me programe e alternativa", tha Dogjani. Për

të cilin me këto deklarata Rama kërkon të largojë vëmendjen e opinionit publik për heqjen nga lista të disa figurave politike e zëvendësimin e tyre me tarafin e lidhjet e tij personale. "Tashmë qytetarët e kanë kuptuar se ky njeri i vogël, pa vizion, ka vetëm një qëllim, pushtetin e tij personal e jo interesat e qytetarëve", tha Dogjani. Nga ana e tij reagon Islami. "Kandidati për kryeminister flet sikur të ishte me sklerozë të avancuar për "besnikë qorra e tradhëtare" apo lëshon mashtrime për "telefonata nga të larguarit", tha Islami. Ai nënvizoi se ndjente turp për këtë spektakël të shëmtuar që detyrohen të shikojnë socialistët që ngjajnë me batutat bajate të një shoferi autobuzi që ka hipur te motori i autobuzit Koçon e të gjithë duken të frikësuar se mos përfundojnë në humnerë.

KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabine "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marrjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brenda dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve, Rr. Dëshmorët e 4 Shkurit, përballë Taiwan Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / **Mob:** 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com



Ministri Noka merr zarf nga Islami dhe flë gjumë në KRRTSRH

Në mbledhjen e 8 Majit me strukturat e PD dhe kandidatët e rinj për deputetë, ish-deputeti i PS Kastriot Islami i pozicionuar djathtas prej kohësh i ka dorëzuar ministrin të Brendshëm, një zarf misterioz. Pak para se të fillonte mbledhja ministri Noka është afruar pranë

Islamit dhe në pak sekonda ka marrë zarfin, e pasi kanë shkëmbyer disa fjalë kanë pritur fillimin e mbledhjes. Ende mbetet mister, nëse Islami i ka dorëzuar Nokës ndonjë listë me sekrete të Ramës, databasën e anëtarëve të PS apo kërkesën e për të qënë anëtarë më i ri i PD. Islami vetë

për gazetën i quajti gesharake këto gjëra dhe të pavërteta. Ndërkohë që po dje ministri Noka në mbledhjen e KRRTSRH është filmuar tek sa flinte. Video ku ish-socialisti i dorëzoi zarfin ministrin Noka si dhe momenti kur është në gjumë ministri u filmua nga kamera e A1REPORT!



Kreu i PS flet për kandidatët, koalicionet: Nano, një mumje

LAJME SHKURT

■ Meta: "Berisha mos më zhenje, Rama do të votojë"

Kryetari i LSI Ilir Meta prezantoi dje në Shkodër kandidatët për deputetë. Ai vuri theksin tek 3 ligjet, duke i bërë thirrje kryeministrit Berisha t'i votojë gjatë kësaj legjislature. "Kreu i PS e pranoi këtë kompromis, jam i zhgënjyer që kreu i PD bën sikur nuk e kupton këtë kompromis që ligjet të miratohen siç janë dhe të hyjnë siç janë, por synimi nuk ka qenë miratimi i 3 ligjeve, por mbushja e Gjykatës së Lartë me militant. Shpresoj të jem i gabuar, në këtë që thamë e uroj që për hir të integritetit të pranohet ky kompromis", tha Meta.

■ Berisha: "Për Ramën 23 qershor dita e gjykimit"

Kryeministri Berisha, ndërsa ka qenë i pranishëm në inaugurimin e rikonstruksionit të rrugës Lis-Ura e Matit, ka sulmuar ashpër dyshen Rama-Kokëdhima. Fillimisht Berisha ka thënë se Rama është bllokuesi i integritetit dhe për këtë arsye ai u ndëshkua nga ana e qytetarëve të Tiranës. Sipas Berishës, 23 qershor do të jetë dita e gjykimit për Ramën. "Modeli i tij është modeli për të cilin qytetarët e Tiranës i thanë rotacion, largohu nga Tirana. Ai kujton se do kthehet nga dritarja, kur Tirana e përcolli nga dera. Modelin Rama-Kokëdhima Tirana e flaku në Lanë. Je më i pashpresë së kurrë", u shpreh Berisha.

■ Kukan: Pakt për KQZ, duhen zgjedhje të pranueshme

Eduard Kukan Kryetari i delegacionit të parlamentit evropian për Europën Juglindore, deklaroi se zgjedhjet duhet të jenë të lira dhe që rezultatit duhet të pranohen nga të gjithë. "Këto zgjedhje duhet të jenë të lira, të ndershme, demokratike dhe në përputhje me standardet evropiane. Anëtarët e KQZ janë emëruar nga partitë politike. Kjo është normale. Por ai duhet të jetë objektiv, drejtë dhe pozitiv. Ju duhet të arrihi një marrëveshje. Sa kohë që s'ka marrëveshje, mbizotërojnë dyshimet për funksionimin e institucioneve demokratike në Shqipëri. Në themi se funksionimi i drejtë i institucioneve demokratike, funksionimi i drejtë i KQZ është ai që pranohet nga standardet evropiane", vijon Kukan.

Lajmi

Kreu i PS Edi Rama është shprehur se menjëherë pas zgjedhjeve do të heqë foton e Presidentit për të vënë atë të Ismail Qemalit. Ndërsa në lidhje me impaktin negativ të tradhetarëve dhe të pavarurëve ai thotë se është zero. Nanon e quan dhe mumje.

TIRANE

ILVA TARE

Rama: Do heq foton e Presidentit nga zyrrat

"Të larguarit nga PS, s'ka budallenj t'i votojnë"



Kreu i PS Edi Rama në "Tonih" të Ilva Tares

"Obamomania"

"Kjo fushatë është e mbushur me elementë të teknologjisë së re e filluar më parë me çiu-çiu dhe sot me të panjohurat në fushatë shqiptare. Unë hyj te ata që duhet të mësojmë me modesti nga bota", tha Rama.

të konsumuara?
Janë normale.

Koço Kokëdhimën e ftuat si mik apo si të majtë në PS?

E kam ftuar si një bir të Bregut që do përfaqësojë Qarkun e Vlorës. E kam ftuar si një botues, që ka kontribuar në vite për të majtën, si një opozitar që i ka rezultuar lirish editoriale dhe presioneve të pashmëbulla si dhe sipërmarrës që është dëshmia e gjallë e rrënimin të mospërfilljes së shkatërrimit të kompanive të veta. E kam ftuar si një person që përmban një kulturë dhe dituri të mjaftueshme për të shtuar një vlerë.

Rikthimi i Fatos Nanos që do jetë përkrash Malajt në fushatë?

Si do thoshte Endri Fuga filmi "Rikthimi i Mumjes"

Po e quani Nanon mumje?
Metaforikisht.

Si do jetë Shqipëria në 24 qershor në fiton ju?
S'kam shkop magjik që ta kthejë më 24 qershor në parajsë.

Nëse e majta dhe e djathta dalin barazim, do uleni me Berishën?

S'ka asnjë mundësi që mbeturinat e së majtës të nxjerrin barazim.

Çfarë do ndryshoni?

Do heqim foton e presidentit. U thashë "Vini Ismail Qemalin". Jo donin Topin e donin Jarin.

Mardhëniet tuaja me kryetarin e Vlorës, janë

Kreu i PS Edi Rama në "Tonih" flet për zgjedhjet e 23 qershorit.

Mbi ç'kritere i bëtë listat për deputet?

S'ka qenë një vendim imi personal dhe pse unë kam fjalën e fundit si kryetar, por është dashur të bëhen konsultime të imëta për të ndërtuar një skuadër komërtbare që të fitojë betejën.

I njihni të gjithë ata që keni vënë në lista?

Sigurisht i njoh.

A u mor mendimi i bazës socialiste?

S'është marrë mendimi në formën e një mendimi tradicional. Nuk e bën asnjë parti që zhvillon zgjedhjet në këtë sistem, por është marrë mendimi i opinionit publik, nëpërmjet anketimit për të testuar çdo skuadër.

Kishite dhe emra të panjohur?

Po kishite. Kemi individë që janë të panjohur ndërkombëtarisht, por që janë të njohur për pjesë të ndryshme të komuniteteve që ata përfaqësojnë.

Me kompaktësinë në një skuadër çfarë nënkuptoni?

Në s'kemi patur asnjë herë probleme diskutimesh, debatesh me rivalitete të ndryshme. Kemi patur një problem që ka qenë ruajtja e një vizioni strategjik dhe bashkimi i energjive për të ndjekur këtë vizion pa vendosur axhendën personale mbi atë të skuadrës sonë. Është kjo axhendë që do ta nxjerrë Shqipërinë nga kriza.

Aleatët, thatë se s'keni nevojë për besnikë gorrë si ata të aleancës së djathtë. Sa mundësi kanë të

përfaqësohen në qeveri? Ne do të ndajmë përgjegjësitë politike në bazë të kontributeve që secili do të sjellë në 23 qershor.

Sa efekte ka dëmi ndaj PS nga largimet e tre deputetëve?

Zero. S'ka budallenj në Shqipëri që të rëndin pas bërthamës. S'do votojnë disa personazhe që kanë dalë në rrugët e kandidimit të pavarur vetëm për të bërë dëm e jo për të marrë mandat.

Edhe kandidimi i Prift-

"Nanon nuk e kam bërë unë kundërshtar. S'kam asnjë arsye që të shoh të gjithë rrugëtimi im si kreu i PS shkakun e sjelljes të papranueshme të tij ndaj PS".

it përveç Malajt si i pavarur?

Këtu përfshihen çdo lloji prifti e hoxhe që nuk është as prift as hoxhë. Të thuash jam socialist i vërtetë, do thotë që në mënyrën më qorre ti s'behesh pjesë e pushtetit të Sali Berishës.

Moskandidimi i Agron Dukës ka qenë presion

i LSI për t'i lënë vend Lefter Kokës në Durrës?

Jo. Unë kam mbrojtur mendimin se dy kunetër në dy forca aleate në të njëjtin front, do ishte shumë për një qark.

Mund të shkaktojë probleme për PS kandidimi i Dukës në PR...?

Zero.

Pse nuk u përfshi në listë Ilir Gjoni, marrëdhënia me të?

Listat janë ndërtuar për të patur inpaktin maksimal në territorin publik. Marrëdhëniet janë normale.

Pse kandiduat në Vlorë?

Si i lindur dhe i rritur në Tiranë, i bie të kem komplekse në Tiranë. Unë në Tiranë jam, në Tiranë do bëj fushatë si kudo në Shqipëri. Kam zgjedhur qytetin e pavarësisë, kjo pasi përbën mesazh shumë të thjeshtë. Pas 100 vitesh ne kemi nevojë për të marrë përsipër ndryshimin. Duke kandiduar në Vlorë në fakt kushdo që është deputet i Vlorës ka privilegjin të jetë deputet i çdo troje, sepse është Vlora është qyteti i pavarësisë.

E bëtë për normalizuar lëvizjen e 3 deputetëve të PS nga Vlora?

Jam krenar kur dëshmoj këto emra si Arben Isaraj e Eltar Deda apo të tjerë. Jam i bindur se ata s'janë aspak të lumtur që s'janë në skuadrën e Rilindjes, me shumë përkushtim për qëllimin tonë të përbashkët, ata kanë mbajtur qëndrime shëmbullore. PS është krejt e ndryshme nga sa e përshkruajnë tradhtarët apo renegatët që u bënë zhele e shkuan bashkë me Saliun.


E keni fjalën edhe për Malajin për tradhetarë?

Për axhendë personale të mbivendosur mbi axhendën

"Ne mund mund të jemi modern. Ne duhet të jemi racional, evropian, por duhet të ndjekim me shumë mençuri dhe urrejtje rrugën e duhur pa bërë kapërcime që stonojnë".

kombëtare të PS, që e bën inkopatibël rolin e një individi në një skuadër. Askush nga ne nuk është i domosdoshëm që të çenojë në mënyrë të vazhdueshme axhendën e përbashkët duke vendosur një axhendë personale.

Mardhëniet tuaja me kryetarin e Vlorës, janë



ESI kritik mbi situatën parazgjedhore në Shqipëri

Shkarkimi i anëtarit të KQZ, i paligjshëm

BE të përgatitet për kontestimin e zgjedhjeve

Lajmi

Vijojnë sërish kritikën për zgjedhje pa standarde që do të mbahen në vendin tonë në 23 qershor. Kjo organizatë dënoi shkarkimin e anëtarit të KQZ si dhe paralajmëroi Europën për zgjedhje të kontestuara.

më të fundit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, thekson se në këtë institucion me shkarkimin e një prej anëtarëve të saj janë thyer rregullat të rëndësishme ndaj për këtë arsye ai ka kërkuar që BE të mbajë një qëndrim.

APELI

Në emër të ESI, drejtori Gerald Knaus i bën apel Bashkimit Europian që të shprehë një qëndrimin e bashkuar, duke paraprirë se zgjedhjet nuk do të jenë perfekte. "Nëse linjat e kuqe janë kapërcyer dhe rregullat të rëndësishme janë thyer, siç e pamë edhe kohët e fundit në shkarkimin e paligjshëm të një anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, BE-ja duhet të flasë më me forcë se ajo ka bërë deri më tani. Mbi të gjitha BE duhet të përpqet për të qëndruar të bashkuar. Komisioni Evropian, të gjitha grupet e mëdha politike në Parlamentin Evropian, nga Qendra e djathtë deri te liberalët në qendrën e majtë, të gjitha shtetet kyce anëtare, si Italia dhe Gjermania duhet t'u tregojnë palëve në Tiranë të njëjtën gjë: këtu janë vijat tona të kuqe të zaksoshme. Nuk duhet të joshet për t'u kaluar ato. Dhe pastaj, kushdo që fiton, humbësi duhet të pranorë rezultatit si legjitim. Zgjedhjet në Shqipëri nuk do të jenë të përkryera. Ata nuk mund të jenë të tilla dhe do të ketë probleme në instalimin e demokracisë. Por, disa probleme janë shumë më serioze se të tjerat. Kjo është arsyeja pse ne argumentojmë për nevojën për t'u përqendruar në atë që është thelbësore, jo vetëm në atë që është e dëshirueshme", nënvizon Knaus.

TIRANË

ARTEMISA HOXHA

KQZ vetëm me katër anëtarë u kritikua dje nga drejtori i Iniciativës Europiane për Stabilizim (ESI), Gerald Knaus. Ai është shprehur edhe një herë kritik ndaj situatës që është krijuar në vendin tonë vetëm pak ditë para mbajtjes së procesit zgjedhhor nga ku do të dalin deutejtë e Kuvendit të ri në 23 qershor. Ai vlerëson se Bashkimi Evropian duhet të jetë e qartë në lidhje me zgjedhjet parlamentare që priten të mbahen më 23 qershor në Shqipëri, duke vendosur ato që ai i ka cilësuar si "vijat e kuqe" që nuk duhet të kalohen. Knaus, thekson se situata parazgjedhore paraqitet e polarizuar, ndaj Bashkimi Evropian duhet të përgatitet



Drejtori i Iniciativës Europiane për Stabilizim (ESI), Gerald Knaus

Vëzhgimi

Në krye të misionit të vëzhguesve të ODHIR do të jetë një eksperte amerikane e zgjedhjeve, që shkon në një linjë me shtetësimin e rritur dhe publik të SHBA për procesin e 23 qershorit.

për kontestimin e rezultatit nga palët. Kritikën vijojnë ku ai thekson se 2 gjëra të rëndësishme duhen parë në një situatë të tillë. "Së pari, nuk duhet të krijohet asnjë iluzion. Zgjedhjet e mëparshme në Shqipëri janë shoqëruar nga polemika, parregullsi dhe me rezultat zgjedhës të sfiduar. I tillë ishte rasti në vitin 2009. Pas zgjedhjeve politika u paralizua, u bojkotua Parlamenti, ndërsa opozita nisi një grevë urie. Dikush sigurisht mund të shpresojë për një surprizë pozitive dhe zgjedhje të pakontestueshme në qershor të 2013, por politika e BE-së duhet të bazohet në supozimin e kundërt: që këto zgjedhje do të jene te kontestuar dhe se të gjitha palët do të përpqen për të bërë

presion mbi administrimin e zgjedhjeve. Në fund, kushdo që është deklaruar të ketë humbur do të sfidojnë legjitimitetin e të tërës procesit. Dhe humbësi i madh në një skenar të tillë do të jetë Shqipëria si një e tërë. Bashkimi Evropian ka deklaruar se ai pret që këto zgjedhje të përmbushin standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Ai tani duhet të shpalosë më konkretisht se çfarë do të thotë kjo, se çfarë janë vijat e kuqe që nuk duhet të kalohet. Kjo nuk do të zvogëlojë fleksibilitetin e saj. Në të kundërtën: ai është një parakusht që ajo të ketë ndonjë ndikim të vërtetë", thekson Knaus. Në këtë vijë mendimi, drejtori i Iniciativës Europiane për Stabilizim duke komentuar zhvillimet

Kthehen 5 parti

Shqyrtohen sot listat, PD LSI ndryshojnë kandidatët

Partia Demokratike ka bërë një tjerë ndryshim në listën shumëemërore në Qarkun e Shkodrës, ku ka ndryshuar kandidatin me numër rendor 10 ku në listat e para ka qenë Merita Gradeci (Ahmetagaj), kun ë vend të saj është vendosur Irma Musa Kopliku Allushi. Ndërkohë që edhe në Qarkun e Triranës kishte ndryshuar pikërisht dy kandidatët atë më numër rendor 20 ku është vendosur Baki Shehi dhe në vend të 32 është futurë në listë Greta Koçi, të dy emra që kanë përjashtuar nga lista shumëemërore Sahit Dollapin dhe Krenar Alimehmetin. Pas shumë ditësh, vetëm dje u bë e mundur publikimi i listave shumëemërore të partive nga ana e KQZ. Edhe LSI ka ndryshuar në qarkun e Shkodrës renditjen e kandidatëve nr 5 Artan Bushati me Ridvan Hebah numër 3. Ndërkohë që në qarkun e Elbasanit LSI ka larguar nga lista kandidatin me nr.14 Veiz Boja dhe nr 16 Agron Roka ku edhe nuk i ka zvendësuar ata. Edhe në Fier nr 6 Frederik Çuko është ndërruar me nr 7 Elinor Shani. Ndërkohë



që sot priten të shqyrtohen dhe listat shumëemërore të 12 partive, ndërmjet tyre PS, PD LSI.

KANDIDATË TË NJËJTË

KQZ ktheu për plotësim të listave shumëemërore 5 parti nga 22 që u shqyrtyuan dje, kjo për shkak se kandidatë të njëjtë ishin regjistruar në parti të ndryshme.



SPITALI ITALIAN MULTISPECIALISTIK

Sherbimet:

- Kardiologji
- Gastrohepatologji
- Endokrinologji-Diabetologji
- Laborator Analizash
- Radiologji (CT, MRI, EKO)
- Okulistike
- Otorinolaringologji (Falas)
- Ortopedi (Falas)
- Kirurgji e përgjithshme
- Kirurgji Estetike
- Neurokirurgji
- Mjekësi Interne
- Stomatologji
- Urologji
- Pediatri
- Gjinekologji
- Check-Up

POLIAMBULATORI I RI SALUS NË QENDËR TË TIRANËS

VIZITA FALAS !

Në qendër të Tiranës kemi hapur poliambulatorin e ri në rrugën Donika Kastrioti, afër dy Kullave Binjake. Këtu janë specialitetet dhe mjekët që do të gjeni dhe do ju presin:

- Gastroenterologji, Ekografi, Endoskopi digjestive - Dok. Emira Zyka
- Kirurgji e përgjithshme dhe Onkologjike (Tumore) - Dok. Luca Calligaris
- Mjekësi e Organeve të brendshme dhe Diabet - Dok. Stefano Turchetto
- Ortopedi - Dok. Mauro Cardinale
- Dok. Leonardo Basso
- Dok. Mauro Di Leo

Përfitonit tani...!

ME "SALUS" CILESIA ITALIANE NE TIRANE

Për të lënë një takim, telefononi në :
 Salus Tirana Sh.a : + 355(0) 4 2390500
 + 355(0) 66 2053 180

KRRTRSH miraton

2 leje për resorte

në Gjirin e Lalzit

Komiteti shtetëror për rregullimin e territorit ka miratuar dje leje zhvillimi për dy resorte turistike në Gjirin e Lalzit, në Durrës, si dhe shtatë leje infrastrukturore për ndërtim hidrocentralesh në vend. Po kështu, KRRTRSH ka vendosur të lejojë ndërtimin e shtesës së godinës së Korpusit Politeknik Universitar në Tiranë. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së

Shqipërisë ka shpeshuar mbledhjet kohë e fundit, për të marrë vendime në prag të zgjedhjeve parlamentare të qershorit. Ai u mbledh dje, pasditën e të premtes, nën drejtimin e kryeministrit Sali Berisha, ku u shqyrtuan një sërë projektesh për HEC-et dhe objekte arsimore e turistike. Shefi i qeverisë tha se "energjia është një ndër sektorët më të rëndësishëm të

zhvillimit të vendit. Ka nisur ndërtimi i një serie HEC-sh dhe së shpejti nis investimi më madhor që është Kaskada e Devollit". Ai shtoi se "në mandatin e ardhshëm starton projekti 'Shqipëria lider' apo superfuqi energjetike në rajon për energjinë e rinovueshme", teza këto që Berisha i ka përsëritur shpesh kohët e fundit.

Rikthimi i ritmeve të zhvillimit duket i largët

BSH: Në "frenim" rritja ekonomike

"Ngecja" e papunësisë tregon paaftësi



Banka e Shqipërisë

TIRANE

GENC KONDI

Lajmi

Ekonomia shqiptare është e paaftë të prodhojë punësim, ndërkohë që ritmet e rritjes së saj kanë rënë në ritmet më të ulta të këtyre 15 viteve të fundit. Kanë deklaruar kështu përfaqësuesit e BSH në prezantimin e raportit të politikës monetare

Sipas Bankës së Shqipërisë, rikthimi i ekonomisë së vendit në ritmet e rritjes së para vitit 2008, prej mesatarisht 6% në vit, duket i largët. Zhvillimet në ekonominë e huaj jo të favorshme; dinamika më e ngadaltë e rritjes së eksporteve vendase, kushtet e huaja të financimit, që mbeten të shtrënguar, janë disa nga faktorët që do të frenojnë rritjen ekonomike

Ekonomia shqiptare pritet që të rritet nën kapacitetet e saj, jo vetëm për vitin 2013, por edhe

në një periudhë afatmesme, ndërkohë që çmimet pritet të jenë të ulëta, sipas ekspertëve të Bankës së Shqipërisë, të cilët janë shprehur gjatë prezantimit të raportit të politikës monetare për tremujorin e parë të këtij viti. Ritmet e rritjes së kredisë janë ngadalësuar ndjeshëm gjatë muajve të parë të këtij

viti, pohuan ekspertët e Bankës së Shqipërisë, duke u zgjeruar me vetëm 1.7% me bazë vjetore për periudhën janar-shkurt. Arsyeja kryesore, sipas tyre, lidhet me kërkesën e dobët nga bizneset e konsumatorët, por edhe nga sjellja e bankave, të cilat kanë shtrënguar standardet e kredidhënës.

BSH pret një rritje të ulëta ekonomike edhe për vitin 2013, ku parashikohet një kontribut pozitiv nga eksportet neto dhe sjellja fiskale, ndërkohë që konsumi dhe investimet private do të vazhdojnë të jenë të dobëta. "Hendeku negativ i prodhimit do të vazhdojë edhe kjo do të ushtrojë më pak presion tek çmimet," pohuan ekspertët e

BSH-së. Inflacioni pritet të luhatet në nivelet midis 0.6-3.6%. Sipas BSH, punësimi në ekonominë shqiptare gjatë viteve të fundit është në stanjacion. Banka e Shqipërisë vlerëson se "ngecja" e

treguesit të papunësisë pranë nivelit 13% është një tregues se ekonomia shqiptare është më pak e aftë të prodhojë rritje dhe punësim, si rezultat i efekteve në rritje të krizës në ekonomi.

Eksporti

Fasonet, në rënie gjatë katër muajve

Sektori i industrisë me material porositi është përballur me rënie të eksporteve në katër muajt e parë të këtij viti. Kryetari i Dhomës së Fasonistëve, Gjergji Gjika, është shprehur se këto tendenca duhet të jenë të shtrira në kohë. Ndërkohë, fasonistët janë në pritje të efekteve të heqjes së tatimit mbi të ardhurat personale dhe heqjes së TVSH-së për makineritë. Ligjet për këto ndryshime kanë hyrë në fuqi më 1 maj. Aktualisht, në kushtet kur një pjesë e konsiderueshme e shteteve të Europës ndodhen prej kohësh nën efektet e krizës ekonomike, sfidë e industrisë me material porositi është gjetja e tregjeve të reja.

Vlerësimi

BERZH: Rritja nën parashikimin

Rritja ekonomike e Shqipërisë për vitin 2013 pritet të jetë 1.5 për qind, sipas Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ky vlerësim i ri përfshihet në njoftimin e kësaj banke të ditës së djeshme, ku ka rishikuar në ulje tendencat e ekonomisë shqiptare, në krahasim me pritshmëritë e shprehura gjatë muajit janar të këtij viti, kur rritja pritej të ishte 2 për qind. Ndryshimi, pas vetëm katër muajsh, është me -0.5 pikë përqindjeje.

Ritja në 2013 pritet të jetë, madje, më e ulët se në 2012-n, vit, për të cilin BERZH jep të njëjtin vlerësim me INSTAT-in, për një rritje të Prodhimit të Brendshëm Bruto shqiptar në masën prej 1.6 përqindësh.

Në tërësi, sipas BERZH-it, rritja ekonomike në vendet në tranzicion pritet të ngadalësohet më tej, nga një normë tashmë e ngadaltë



Selia e BERZH në Londër

prej 2.6 përqindësh vitin e kaluar, në 2.2% në 2013. Kjo është pothuajse një pikë përqindjeje më e ulët se parashikimi i janarit. Një rimëkëmbje modeste prej 3.2% pritet vetëm vitin e ardhshëm. BERZH thekson se një gjallërim i reformave strukturore është i nevojshëm, në mënyrë që të shtrohet rruga për një rritje më të ndjeshme në të ardhmen.



NOTIFICATION OF PREQUALIFICATION RESULTS

Name of Procuring Entity: Albanian Development Fund
Name of Project: Secondary and Local Roads Project
Project EBRD – ID: 40153
Project BEI – ID: 2007 – 0519
Tender/Contract Description: Contract No. 1: CWC/ICB/2013/WL – Rec 95, Reconstruction of road Balez – Letan, in Elbasan Region
Contract No. 2: CWC/ICB/2013/WL – Rec 136, Contract Reconstruction of road Bexull – Laknas, in Tirana Region
Contract No.3: CWC/ICB/2013/WL – Rec 137, Reconstruction of the roads connecting Farka with Elbasani road, in Tirana Region

Applicants Prequalified

No. of Contracts	
1	Albavia sh.p.k.
1	SK – 13 Patstroy
1	ANK sh.p.k.
1	Geci sh.p.k.
1	Albakonstruksion sh.p.k.
2	Gjoka Konstruksion sh.a.
1	Gjokuria sh.p.k.
1	JV SMO Union sh.p.k. & Curri sh.p.k.
1	Salillari sh.p.k.
2	Gener 2 sh.p.k.
1	JV Riviera sh.p.k. & Co.Be.In. sh.p.k.
1	Filipos S.A.
1	Copri Construction
1	Vezzola
1	JV Alb Building sh.p.k. & 2 T sh.p.k.
1	JV Trikat S.A. & Pe – Vla – Ku sh.p.k.

Rejected Applicant

1	RSM
2	Çilotaj Group sh.p.k.
3	Egnatja ATEVE
4	JV Albakonstruksion sh.p.k. & Spartaku sh.p.k.
5	Eurokos
6	JV Beozzo & Sitto

In all cases the Procuring Entity shall undertake verification at the time of tendering, and that tenders shall be rejected by the Procuring Entity, at its discretion, if the verification is unsatisfactory or if the tenderer is unable to confirm the specified requirements.

Only applicants (firms or joint venture) that have been prequalified under this full process will be eligible to tender.

The tender documents will be issued only to prequalified firms.



Punimet në rrugën e “Dibrës”, devijojnë qarkullimin

Rikonstruksioni i rrugës së “Dibrës”, kudo të bëjë që për dy ditë të ndysojë drejtimi i qarkullimit të automjeteve. Bashkia Tiranë, informon se si pasojë e kryerjes së punimeve (asfaltim), ndalohet qarkullimi i mjeteve në rrugën e “Dibrës”, nga kryqëzimi me rrugën “Siri Kodra”, deri në kryqëzimin me rrugën “Bardhyl”, duke filluar nga ora

21.00 e datës 11.05.2013, deri në datën 13.05.2013. Qarkullimi i automjeteve, mjeteve të emergjencës dhe Policisë së Shtetit, në segmentin e rrugës së “Dibrës”, nga kryqëzimi me rrugën “Siri Kodra”, deri në kryqëzimin me rrugën “Bardhyl” do të kryhet me një sens lëvizjeje, sipas drejtimit lindje - perëndim. Shërbimi i linjës së transportit urban “Kombinat-

Kinostudio”, në një pjesë të saj do të kryhet me itinerare: Qendër – rruga e “Barrikadave” – “Ferit Xhajko” – rruga e “Dibrës”, sipas dy drejtimeve të lëvizjes. Shërbimi i linjës së transportit urban “Tufina” në një pjesë të saj do të kryhet me itinerare: Qendër – “Luigj Gurakuqi” – “Hoxha Tahsim” – “Bardhyl” – rruga e “Dibrës”, sipas dy drejtimeve të lëvizjes.

Statistika lufte, 334 të vdekur nga aksidentet rrugore për një vit

Nxënësit-policë, edukim në trafik

Në kuadër të Javës Botërore për Sigurinë Rrugore, Kombet e Bashkuara në bashkëpunim me “Vodafone Albania” e policinë organizuan aktivitete me nxënësit e 9-vjeçarëve

TIRANE

JONIDA LATE

Lajmi

334 persona kanë humbur jetën gjatë vitit të kaluar vetëm nga aksidentet rrugore. Shkak për humbjen e kaq shumë jetëve janë bërë mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor, si nga drejtuesit e automjeteve ashtu edhe nga këmbësorët.

Mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor si nga këmbësorët ashtu edhe nga drejtuesit e automjeteve dhe mungesa e sinjalistikës ka bërë që vitin që kaloi të humbin jetën 334 persona dhe 481 të tjerë kanë pësuar dëmtime të rënda si pasojë e aksidenteve rrugore. Por, po në vitin 2012 ka pasur plot 1870 aksidente rrugore. Shifrat

janë bërë publike nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara dhe Policia e Shtetit gjatë një aktiviteti të përbashkët me “Vodafone Albania”. Por përveçse se mungesës së sinjalistikës, shqiptarët vuajnë

edhe nga mungesa e edukatës dhe e respektimit të vijave të bardha brenda qytetit. Për këtë arsye disa të rinj, nxënës të shkollave të mesme në Tiranë janë angazhuar nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara në

bashkëpunim me Policinë e Shtetit për të demonstruar sesa e rëndësishme është respektimi i rregullave dhe dhënia përparësi kalimtare në vijat e bardha. Për të shmangur këto shifra, por edhe në kuadër të javës botërore për sigurinë rrugore Kombet e Bashkuara në bashkëpunim me “Vodafone Albania” dhe policinë e shtetit kanë organizuar aktivitete me nxënës të shkollave 9-vjeçare të Tiranës nën moton “Jam këmbësor, kam përparësi”. Ledio Isufi një drejtues automjeti shprehet se problemi është tek të dyja palët, edhe të këmbësorët dhe të drejtuesit. “Unë kam qenë në të dyja rastet shpeshherë këmbësorët kalojnë në mes të rrugës, duke haruar që kalojnë makinat. Por ka edhe drejtues mjeteve që ecin pa kujdes”. Po në kuadër të javës Botërore të Sigurisë edhe Ecovolis, ka ndërmarrë një nisim për disa aktivitete. Ata dje kanë bërë një vërshim mbi biçikleta të mbi 100 të rinjve, nxënës të Gjinnazit “Qemal Stafa”, në qendër të Tiranës. Pikërisht, për të nxitur jo vetëm pedalesit aktualë por dhe brezat në rritje, këtë vit programi i Javës Botërore për Sigurinë Rrugore ka në qendër të vegjlit dhe të rinjtë, ata



Nxënës të shkollave të ndryshme të veshur si policë rrugorë

që rriten mes makinave dhe transportit pasiv, e që kanë nevojë për motivim të veçantë për t’iu drejtuar dyrrrotakut, këmbësorisë, patinave apo çdo mjeti tjetër të shëndetshëm, të sigurt dhe ekologjik. Nga data 6-13 është java e sigurisë rrugore e cila i dedikohet tërësisht këmbësorëve. Shpresohet që aktivitetet e organizuara të rrisin

ndërgjegjësimin në mënyrë që të shpëtohen jetë. Pakujdesitë, por edhe shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor janë shkakta kryesore të vdekjeve të 1.3 milionë njerëzve në botë dhe plagosjen e të paktën 50 milionë njerëzve në botë. Të dhënat zyrtare tregojnë se një çerek milionë njerëz kanë humbur jetën duke qenë këmbësorë.

NOTIFICATION OF PREQUALIFICATION RESULTS

Name of Procuring Entity: Albanian Development Fund
 Name of Project: Secondary and Local Roads Project
 Project EBRD – ID: 40153
 Project BEI – ID: 2007 – 0519
 Tender/Contract Description: Contract No. 1: CWC/ICB/2013/WL – Rec 50, Reconstruction of road Kthesa e Qarrit – Bishan – Poro – Pish Poro – bregdet, Fier Region
 Contract No. 2: CWC/ICB/2013/WL – Rec 52, Contract CWC/ICB/2013/WL-Rec 52, Reconstruction of road Libonik – Rrembec – Plase, Korça Region
 Contract No.3: CWC/ICB/2013/WL – Rec 138, Reconstruction of road Surrel – Qafe Priske, Tirana Region

Applicants Prequalified

No. of Contracts

1. Gener 2 sh.p.k.	3
2. ANK sh.p.k.	1
3. Gjiguria sh.p.k.	1
4. JV Curri sh.p.k. & SMO Union sh.p.k.	1
5. JV Riviera sh.p.k. & Co.Be.In. sh.p.k.	1
6. Gjoka Konstruksion sh.a.	2
7. Salillari sh.p.k.	1
8. Serenissima Costruzioni	1
9. Filipos S.A.	1
10. Copri Construction	1
11. JV “Pe – Via – Ku” sh.p.k. & “Trikat” S.A.	1
12. JV Alb Building sh.p.k. & 2T sh.p.k.	1
13. Vezzola	1

In all cases the Procuring Entity shall undertake verification at the time of tendering, and that tenders shall be rejected by the Procuring Entity, at its discretion, if the verification is unsatisfactory or if the tenderer is unable to confirm the specified requirements.

Only applicants (firms or joint venture) that have been prequalified under this full process will be eligible to tender.

The tender documents will be issued only to prequalified firms.

Rejected Applicant

1. Taddei
2. Impresa s.p.a.
3. Çilotaj Group sh.p.k.
4. Geçi sh.p.k.
5. Albania sh.p.k.
6. Eurokos
7. Agbes Construction sh.p.k.
8. Famis
9. Strabag
10. Socab
11. Egnatia ATEVE
12. GB Put
13. JV Beozza & Sitto

Këshilli

Dalipi: Basha po shkakton stafin e Këshillit Bashkiak

TIRANE



Aldrin Dalipi

Kryetari i Këshillit të Bashkisë së Tiranës, Aldrin Dalipi, shkruan në rrjetin social “Të tter”, se kryetari i Bashkisë së Tiranës Lulzim Basha, po shkakton stafin e Këshillit Bashkiak. “Këshilli Bashkiak është institucion i pavarur kushtetues, nuk ka asnjë të drejtë ligjore dhe institucionale Basha mbi stafin e Këshillit Bashkiak!” shkruan Dalipi. Kryetari i Këshillit Bashkiak, Aldrin Dalipi, i zgjedhur me votë nga shumica, pas shkaktimeve dhe emërimeve më të fundit në radhët e këtij Këshilli. Duke iu

referuar ngjarjes së ndodhur disa ditë më parë, kur detyrë të Këshillit Bashkiak u ishin ndërruar bravat dhe çelësat, Dalipi thotë se “Luli mos ngatërrojë specialistët e Këshillit Bashkiak me bravat dhe çelësat që i ndër-

roi natën. Nuk është kjo formë që nderon Bashkinë. Veprime antieuropiane!” Këto deklarata të Dalipit vijnë pas shkaktimeve në stafin e Këshillit Bashkiak, duke theksuar se “nuk do t’i njohin këto vendime, pasi janë kundër ligjit”. Ndërkohë që shton se “Presioni dhe shkakimet e stafit të Këshillit Bashkiak pas kryerjes së procedurave të mbledhjes së Këshillit që shkarkoi Kosovrastin. Presioni tregon panik!” përfundon Dalipi. Para tre ditësh ish-kryetari i Këshillit Bashkiak, të Tiranës Njazi Kosovrast, ka depozituar në Prokurorisë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kallëzim penal për sekretarin e Këshillit Bashkiak, Behar Zeneli.



Intervista

KREU i bashkisë së qytetit bregdetar, Himarë, në çelje të sezonit turistik tregon sfidat




Stadiumi i Himarës



Ekipi i volejbollit, Himara



Moment nga konkursi "Zërat e rinj"



Jorgo Goro: Ja si do t'ju presë Himara këtë vit

"Si ndryshuam jetën artistike. Sivjet, një sezon të mbarë"

Lajmi

Një nga perlat e bregdetit shqiptar, Himara, çel sot sezonin turistik. Bashkia ka planifikuar një sërë aktivitetsh, ndërkohë që kryetari i saj, Jorgo Goro, në një intervistë për Shqiptarja.com, tregon risitë e këtij sezoni dhe aktivitetet që mbështet e organizon pushteti vendor.

torë, me këngëtarët e njohur Ermira Babaliu, Kozma Dushi, Ylli Baka, Amalia Goro etj, do të japin një shoë për të gjithë ata që duan të shijojnë hotelet, bregdetin, koncertin, njerëzit e gjithçka tjetër në qytetin bregdetar.

Zoti Goro, falemnderit që gjetët kohë për këtë intervistë. Si po ecin përgatitjet e fillimit të sezonit?

Gjithçka po shkon në

Veçem me një sezon të shkurtër turistik s'mund kemi një turizëm të suksesshëm. Duhet të afrojmë risi të ndryshme që të kemi njerëz në Himarë në çdo kohë dhe këtë e kemi arritur dhe do të vazhdojmë ta arrijmë falë shërbimit

mënyrë të shkëlqyer. Jemi duke u përgatitur për të pritur me mijëra e mijëra turistë, nga vendi, por edhe shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve të vendit. Falenderoj median që i ka dhënë një vëmendje të posaçme hapjes së sezonit turistik në Himarë, që sikurse mund ta keni vënë re, tani po bëhet një praktikë e përvitshme. Kemi punuar shumë gjithë këtë vit, edhe pse me fonde të pakta nga ana e pushtetit qendror, por me kontributin e dashamirësinë e të gjitha bizneseve të zonës,



Kryebashkiaku i Himarës, Jorgo Goro duke lexuar gazetën "Shqiptarja.com"



Plazh në Himarë

që të garantojmë për këtë vit, një sezon që të na sjellë ne jo vetëm me mijëra turistë, por që të krijojmë kushtet

dhe premisat që të gjithë ata që vijnë e na nderojnë me prezencën e tyre në qytetin tonë, të mbeten të kënaqur

nga cilësia e shërbimit dhe organizimi i eventeve, për t'u kthyer sërish në qytetin tonë, e jo vetëm në verë, por edhe në dimër.

Pas gjithë kësaj panorame, duhet të kuptoni se një ndër shqetësimet që kanë qytetarët është cilësia e shërbimit por edhe pastrimi i plazhit. Sepse, në shumë zona bregdetare, duhet ta kuptoni se këto krijojnë shqetësime për

Një tjetër risi e gjallërimit të jetës sportive është edhe ekipi i vajzave në volejbol që luan në Ligën Superiore të Kampionatit Kombëtar në Shqipëri. Vajzat që përfaqësojnë ekipin e Himarës kanë luajtur ndeshje mjaft dinjitoze

pushesit...

Bëtë mirë që më dhatë mundësinë të shprehem për këtë problem. Si rrallë më parë, për këtë vit, bashkia e Himarës ka pasur një organizim të shkëlqyer me të gjithë nxënësit e shkollave të mesme në zonë, kuptohet, në mënyrë vullnetare. Edhe para disa ditëve në Himarë ne zhvilluam një aksion masiv në mbledhjen e mbeturinave, kryesisht në ambiente publike dhe plazhe. Ky projekt u iniciua nga Bashkia e Himarës dhe në të u përfshinë punonjësit e Bashkisë, institucioneve shtetërore, si dhe të rinjtë e shkollave të Himarës. U pastrua ngado. Në Himarë qendër, në Potam, në Livadh etj. Qese të tëra me plehra, materiale inerte e gjithçka shite syri i njeriut u hoqën. Sigurisht, unë jam i bindur se kjo është një çështje që nuk bëhet vetëm nëpërmjet aksioneve. Gjatë fillimit të sezonit, kemi kërkuar mirëkuptimin e gjithë bizneseve, sidomos në zonën e plazhit, që të organizohen për të ruajtur sa më pastër ambientin rreth tyre dhe zonën e plazhit në mënyrë që syri i qytetarëve të gjejë qetësinë me detin, ambientin, peizazhin, por të jenë të kënaqur edhe me shërbimin.

Gjithçka që ndodh në qytet nuk ka të bëjë vetëm me pastrimin apo sezonin. Çfarë aktivitetsh ka planifikuar apo ka bërë bashkia e Himarës këto kohë?

Po në fakt, jemi munduar që jetës artistike t'i japim një impuls ndryshe nga vitet e tjera ku Himara në fakt nuk është shquar për ndonjë aktivitet të madh. U zhvillua konkursi i "Zërat e Rinj". Kjo për të gjallëruar jetën artistike të Himarës në mënyrë që të mos kushtëzohet gjithë procesi i jetës në këtë qytet vetëm gjatë sezonit turistik. Jemi munduar që jeta artistike, por edhe vetë njerëzit, të kenë aktivitet edhe në dimër. Në këtë nisimë artistike, u përfshinë të gjitha shkollat e himarës, ato 9 vjeçare apo të



Pamje nga Himara dy netë më parë

KEMI pasur projekte të ndryshme dhe të shumta në qytet gjatë sezonit të dimrit, kryesisht nga OJF ndërkombëtare

JEMI përpjekur që të ngremë në një standard tjetër ekipin e Himarës në futboll. Ky ekip është mbështetur financiarisht nga Bashkia e Himarës

TE HUAJT ME KROÇERE

Pushimet jashtë, bie numri i prenotuesve

Zgjedhjet largojnë mendjen nga sezoni

TIRANE

Edhe pse sezoni turistik ka trowitur e bashkë me të duhet të nisim edhe diskutimet për pretonimin e pushimeve, shqiptarët duken ende larg këtij entuziazmi. Zgjedhjet elektorale kanë përfshirë nga ethet gjithë administratën publike, por jo vetëm. Ne zyrat e administratës shtetërore, shume prej punonjësve nuk kanë paraqitur kërkesat për leje dhe planifikimi i tyre mungon. Shkak është jo vetëm angazhimi në zgjedhje, por edhe frika për ndryshime në dikastere pas një rotacioni të mundshëm politik. Kjo stepje konfirmohet edhe nga operatorët turistikë, të cilët i kanë ulur ndjeshëm pretonimet e çarterave për periudhën qershor-korrik. E bashkë me këtë situatë, prezente është edhe kriza ekonomike, e cila ka gjunjëzuar shumë prej bizneseve, të cilët janë në vështirësi financiare. Ky fakt, sipas operatorëve do të stimulojë pushime spontane dhe kryesisht fundjavat. Në ndryshim nga kjo situatë, operatorët thonë, se ka një kategori të vogël shqiptarësh, të cilët mbeten tërësisht indiferent



Turistët
Vetëm tri ditë më parë, në Durrës mbërriti kroçera e dytë për këtë vit, e cila solli 325 turistë, nga shumë shtete të ndryshme. Por veç turistëve ditorë, Shqipëria hyn në axhendat edhe të atyre që kalojnë ditë e javë këtu.

Evropës. Ndërsa kapacitetet hoteliere dhe restorantet, kanë nisur përgatitjet për të pritur pushuesit, kryesisht shqiptarë nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia. Madje, këta të fundit, plazhet e Jugut të vendit tonë i kanë shndërruar në axhendën e tyre të pushimeve prej shumë ditësh. Ndërsa shqiptarët e Kosovës kanë më përzemër plazhet e Durrësit e Shëngjinit dhe prej dy vjetësh, në axhendën e tyre është përfshirë edhe Velipoja. Megjithatë, një pjesë e bashkive kanë çelur zyrtarisht sezonin turistik, të tjera do ta çelin sot e në vazhdim, në pritje të pushuesve të këtij sezoni turistik.

mesme. Madje, edhe juria e kishte të vështirë të zgjidhte fituesin.

Jo vetëm kaq, kemi bërë përpjekjet maksimale që të ngremë në një standard tjetër ekipin e Himarës në futboll. Ky ekip është mbështetur financiarisht nga Bashkia e Himarës dhe më duhet të them se kemi pasur një sezon relativisht të mirë. Ekipi luan në kategorinë

të tjerë të vitit, ku nuk ka një sezon turistik. Stadiumi "Petro Ruci" në Himarë ka qenë në çdo ndeshje i mbushur plot me sportdashësit himarjotë, kur ekipi ynë ka luajtur "në shtëpi".

Një tjetër risi e gjallërimit të jetës sportive është edhe ekipi i vajzave në voleyboll që luan në Ligën Superiore të Kampionatit Kombëtar në Shqipëri. Vajzat që përfaqësojnë ekipin e Himarës kanë luajtur ndeshje mjaft dinjitoze me lojërë të forta përballë ekipeve elitare në këtë sport. Nën drejtimin e profesor Kristo Rondo dhe me mbështetjen e sponsorit tonë, të cilin gjej rastin ta falenderoj, Veneto Banka, ekipi i të rejave të Himarës, do të vazhdojë të luajë edhe në sezonin tjetër ndeshje cilësore. Bashkia e Himarës jo pa qëllim investoi për ta krijuar këtë ekip, kjo i shërben gjallërimit të jetës artistiko-sportive në Himarë.



Fëmijët e shkollave të Himarës duke pastruar plazhet

e Parë. Edhe pse me lojërë të mira, falë tolerimeve dhe luftës jo-sportive për të qëndruar në kategorinë e parë nga ana e ekipeve të tjera, edhe pse në mesin e tabelës, por huajse cdo javë (vendi 17 apo 8), në fund të kampionatit, Himara rezikon rënien nga kategoria. Aktivitetet sportive në fakt, gjallëruan jetën e Himarës gjatë muajve

Në përgjithësi, sa herë turistët vijnë, gjithmonë vëmendjen e kanë në kulturën e shërbimit, ushqimin dhe cilësinë e tij. A kemi folur me operatorët turistikë për të

krijuar një cilësi ndryshe në këtë sezon?

Po, kemi pasur projekte të ndryshme dhe të shumta në qytet gjatë sezonit të dimrit, kryesisht nga OJF ndërkombëtare sidomos për fushën e trajnimit në shërbim. Shumë të rinj nga Himara morën pjesë në kurse trainimi në fushën e gastronomisë, shërbimit kulinar. Jo pa qëllim si kryetar bashkie kam kërkuar që të vihen në jetë projekte të tilla. Jam përpjekur dhe besoj se do tia dalim për të motivuar biznesin e hoteleri-turizmit që pa shërbimin gjatë gjithë muajve të vitit, nuk mund të kemi një sezon të mbarë turistik përpara. Ndryshe nga vitet e tjera, këtë vit kemi pasur shumë operatorë turistikë që kanë ofruar shërbimet e tyre edhe gjatë sezonit të dimrit. Zgjatja në kohë e këtij sezoni, është edhe ajo për të cilën unë jam preokupuar gjatë gjithë kohës. Vetëm me një

ndaj zgjedhjeve dhe krizës ekonomike. Ndaj, ky kontingjent, duket se do të jetë i vetmi fluks shqiptarësh, që do të vijojnë të marrë kënaqësinë e pushimeve. Por, ndryshe nga shqiptarët, të huajt duket se e kanë përfshirë vendin tonë në axhendat e tyre. Vetëm tri ditë më parë, në Durrës mbërriti kroçera e dytë për këtë vit, e cila solli 325 turistë,

nga shumë shtete të ndryshme. Por veç turistëve ditorë, Shqipëria hyn në axhendat edhe të atyre që kalojnë ditë e javë këtu. Plazhet tona, janë mjaft tërheqëse për të huajt, kryesisht ato të bregdetit të Jonit, që nga Vlora, për të vazhduar në Palasë, Dhërmi, Himarë e deri në Sarandë e Ksamil, vizitohen çdo vit nga turisë nga Perëndimi i

sezoni të shkurtër turistik nuk mund kemi një turizëm të suksesshëm. Duhet të ofrojmë risi të ndryshme që të kemi njerëz në Himarë në çdo kohë dhe këtë e kemi arritur dhe do të vazhdojmë ta arrijmë falë shërbimit. Dhe këtë vit men-

doj se do ta kemi shërbimin më lart se në çdo sezon tjetër. Unë uroj dhe shpresoj që ky vit, i cili është i përfshirë edhe në ethet elektorale, të jetë më i mirë se çdo vit tjetër. Të kemi mundësi t'u krijojmë komoditet dhe pushime

të mbara kujtdo, të majtë e të djathtë, shqiptar nga Shqipëria apo shqiptarë jashtë kufijve tanë, evropianë apo mysafirë nga kontinentet e largëta. Këtë vit, jemi përgatitur që ti mirëpresim të gjithë në Himarën tonë. **an.ba**

KËRKOJ APARATE FOTOGRAFIK METALIK TË VJETËR
Tiranë, kërkoi të blej Aparate Fotografik Metalik të vjetër. Koleksionoj aparate fotografike të vjetër të të gjitha markave. **TEL+35569668088**

Blije atë që të duhet!
Shite atë që nuk të duhet!

Tregu më i madh në Shqipëri për shit-blerje

Për më shumë informacion na vizitoni në faqen tonë të ëbsite:
www.MerrJep.al

IPHONE 5 FACTORY UNLOCK
Iphone 5 factory unlock i ardhur nga Italia shumë pak i përdorur as një muaj 16 gb i bardhë.
TEL. 0692401666

PEUGEOT 206 BENZINË 1.1CC.
Shes Peugeot 206 motorr 1.1cc benzinë me dokumenta të rregullta targa Italiane. Makina ka 120.000 km, origjinale me 4 dyer, tapiceri super e pastër me goma të reja të sapo vëna me faturë HANKOOK, disqe alumini, kasetofon mp3.
TEL. 0686803203



Koment

Gazi i botës



NGA **ARDIAN NDRÉCA**

vijon nga faqja 1

... historik me sukses të plotë e pa mbërritë në asnjë rezultat konkret. Mbas atentatit të Azis Çamit e Ndok Gjeloshit kundër Zogut në Vjenë, kemi atentatin e Edi Ramës kundër veshit të pambrojtun të një diplomati

mjeran si vetë ata që e kanë çue në atë vend.

Veshzhgulja e Vjenës me sa duket i ka të gjitha gjasat për me hy në analet e historisë, ashtu siç ka hy poshtnimi i sulltan Bajazitit prej Timurlengut, shputa e Anagnit e Bonifacit VIII, poshtnimi i Enriku IV para kështjellës së Canossa-s... e sa episode tjera të trishtueshme që kanë pa mbretën, princa e presidenta të tutëlohen ndër rrudhat e historisë.

Mbas Kongresit të Vjenës, mbas Wiener Philharmoniker, mbas Wiener Kreis e mbas Wienerwurst, këto të fundit kremviça derri (largqoftë!), në histori do të hyjë edhe "veshzhgulja e Vjenës" dhe komisioni ndërkombtar i incidentit të "veshzhguljes së Vjenës".

Ndoshta e teprova, pse kjo asht një histori që as teatri i kukullave politike



NË FOTO: Egin Ceka duke raportuar në "komisionin e veshit"

të Berishës nuk mbërriti me e vu në skenë. Diplomati i vockël në veskun e tij me dalë si pararojë berishiane poshtë mureve të Vjenës, rrezikoi me u transformue në një visk veshgjatë. Gjithçka ndodhi ndërsa Edi Rama kumtonte diçka që tek ne e dijnë edhe pulat, pra, që diplomacia shqiptare asht në shërbim të pushtetit politik dhe jo të shtetit, një individ i quejtun Egin Ceka, i cili hapet katërsh me fundamentalizmin e tij të thekunj - në një kohë që merr rrogën prej

nji shteti laik - doli me e kundërshtue dhe madje e fyti Ramën.

Nuk e di dhe as që më intereson nëse Rama ia ka zhgulë apo jo veshin, por poshtnimi ma i madh diplomatit të veshzhguljes i erdhi prej të atit, i cili edhe pse asht ba monument arkeologjik vijon me ba zanatin e pehlivanit e me shkue kah të fryjë era. Letra e tij ishte si me pasë dalë prej laboratorit të Shvejkut, diçka përballuese në komicitetin e vet idiotesk.

E gjithë kjo mesele, me gjithë ngarkesën tragjike që kërkonte me i dhanë Berisha po merr gjithnjë e ma shumë konture komike. Edhe vetë komisioni ka diçka groteske, atij i mungonte vetëm eksperti Çardaku që të maste giatësinë e veshit të dhunuem prej kryesocialistit, të konstatonte nëse kanë mbetë shenjat e gishtave...

Pjesa pozitive e kësaj meseleje asht se zhgulja e veshit prej Edi Ramës u ba shkak për dorëheqjen e atij palo diplomati që e turponn Republikën shqiptare, por shpresojmë të bahet edhe precedent për heqjen, mbas 23 qershorit, e shumë spathokëve tjerë që e kanë zaptue diplomacinë tue e çnderue shtetin tonë kudo ku u ka shkelë kamba.

Koment

10 maj – Dita e Drejtësisë!



NGA **AFRIM KRASNIQI**

vijon nga faqja 1

...tek tradita, të tjerë tek paragjykimi nga publiku. Unë futej tek ata që mendoj se përgjegjës kryesor është politika, mungesa e një konsensusi 20 vjeçar për ta bërë drejtësinë, (keq)përdorimi i saj nga pushtetet dhe politika e ditës si dhe vetë gara midis njerëzve të drejtësisë për të zënë sa më shumë miqësi e lidhje personale me politikë dhe politikanët!

Ndaj sot diplomojnë 2600 juristë në vit, por mezi gjejmë një për ta rekomanduar për një punë serioze juridike; kemi ministër drejtësie një jurist që ka braktisur detyrën gjyqësore duke preferuar profesionin fitimprurës të avokatit, përpara se të bëhet edhe politikan; qeverisja e gjyqësorit drejtohet nga një jurist që kurrë më parë nuk ka qenë në një sallë gjyqi dhe as ka shkruar një studim 1 fq. A4 mbi drejtësinë; kemi president, kryetar e zv/kryetar parlamentit me juridik part-time; kemi një kryeministër që flet gjithë ditën për kushtetutën, të cilën e refuzoi/bojkotoi gjatë votimit më 1998 duke e etiketuar si kushtetutë krimi; kemi një kryetar opozite, i cili në emër të ligjit merr sëpatën dhe rrëzon shtyllat e dritës elektrike; kemi vetëm 3% të deputetëve juristë ndaj 17% mësues të gjuhëve të huaja; kemi një komision parlamentar ligjesh ku më i rikandiduar është ai që thyen ligjin sa herë humbet skuadra e tij e futbollit; kemi një komision hetimor parlamentar që drejtohet nga një punonjës social; kemi 2/3 e anëtarëve të gjykatës së

lartë e kushtetuese, të diplomuar fillimisht në filozofi politike ose shkollën e policisë/sigurimit të shtetit; ndërkohë që reformat e premtuara të qeverisë nuk bëhen me ligje në parlament por me shënime të përditshme në Facebook!

Ndaj nuk është çudi kur ndryshe nga vendet e tjera, tek ne asnjë politikan nuk përgjigjet përpara drejtësisë, gjyqet e zyrtarëve të lartë mbyllën "për procedurë", kurse vrasësit më të bujshëm na rezultojnë të liruar për sjellje të mirë! Dhe mbi të gjitha, - në një vend ku për çdo temë ligji përmendim edhe Maliqin, ku policia çdo vrasje e justifikon me kanunin, ku vetëm 45% e qytetarëve

Në nder të vendimit të qeverisë së Vlorës për sistemin gjyqësor, - të pavarur, profesional dhe dinjitoz, - siç e deshëm, por siç nuk e kemi as pas 100 vitesh shtet

paguajnë rregullisht taksat, faturat e dritave, ujit, gjelbërimit, etj, - është e pritshme që koncepti i të drejtës të jetë relativ, sllogan dhe pritshtëmëri e largët. Rëndësi nuk i jepet

brendësisë por imazhit, lajmit: p.sh ministri i drejtësisë ftoi djë në takim ndërimi gjithë ministrat e drejtësisë, edhe ata të periudhës komuniste, ndau ca tituj e lavdërime, por nuk

thia asgjë se çfarë do ndodhë me sistemin që ai drejton. Ndaj nuk reflektojmë si shoqëri, zgjidhet i kërkujmë me greva urie, korrupsion apo ikje nga problemet; palët politike nuk pranojnë nënshkrimin e një pakti kombëtar për reformën në drejtësi; ligjet e drejtësisë nuk votohen, gjyqtarët e lartë nuk zgjidhen me dy të tretat e votave, si dhe shkalla e zbatimit të ligjit varion 35-40%.

Për ata gjyqtarë, juristë, profesionistë, njerëz të ndershëm dhe të drejtë, - pra të gjithë ata për të cilët drejtësia mbetet ende mision, objektiv, detyrë e përgjegjësi, - Gëzuar 10 majin dhe më shumë drejtësi për të gjithë!!!

Blog/ Grimca Urbane

Tirana nuk mban më



NGA **EVIS CERGA**

Nuk e njoh më qytetin tim. Qytetin tim përpara epokës së "Komunës së Parisit". Tirana e shëtitores Dëshmorët e Kombit, Tirana e Krugës së Dibrës, Krugës Bardhyl, Kinostudios, Kombinatit, Laprakës, Liceut Artistik, Krugës Miqësia tani nuk është më. Nuk janë më si pjesë e saj edhe shumë prej banorëve të këtyre rrugëve, të cilët e lanë atë pas për një jetë me të mirë, pa të. A janë ata më mirë pa të? A u

mungon Tirana atyre? Këtë secili prej tyre e di vetë fort mirë. Por unë dua t'ju flas për Tiranën ku qytetarët flasin me të tjerë qytetarë sepe nuk kanë c'bëjnë tjetër përballë rrëmujës urbane, rrëmujës rrugore dhe mbi të gjitha rrëmujës psikike. Tirana që është kthyer në një rrumpallë ku secili bën e flet sic do, kur do dhe kurdoherë. Të më ndjeni që i referohem vetëm Tiranës, mirë do të kish qenë të flisja për të gjithë Shqipërinë, që të ndërjegjësohej i madh e i vogël, por tani nuk kam përse ta bëj një gjë të tillë. Tani e gjithë Shqipëria ka ardhur në Tiranë. Në Tiranën "zemërmadhe" që hapi të gjitha sheshet për ndërtime, në mënyrë që pastaj të gjithë të flisnin për urbanistikën e cmendur të Tiranës, sikur kjo të ishte e Danimarkës dhe ne të mos na takonte fare se c'ndodhte. Në Tiranën, ku të gjithë flasin një ditë po e një ditë po për mjedisin dhe vetëm mjedis

nuk ka. Po, ka ambiente, ambiente për restorante me lodra për fëmijë pa kurëfarë kriteri për vendosjen dhe mirëmbajtjen e tyre. Kafene të zhvendosura sipër, anash, në mes dhe lart e më lart trotuareve. Tirana me Liqenin Artificial, që e bekoftë Perëndia atë që ia gjeti emrin, se më artificial se është në ditët e sotme nuk ka qenë kurrë. Tirana e mbushur me makina që përves se funksionojnë në të shumtën e herëve jashtë çdo standardi, shpesh kanë për pronarë njerëz të vrazdhe e të nxituar, që nuk presin dot në semafor se ngjyrat i kanë mësuar që në kopësht dhe nuk duan t'i shohin prapë. E çfarë të shkruaj më parë në këto pak rrjeshta për Tiranën. T'ju flas për Tiranën kur njerëzit ndaloni për t'i folur me respekt njëri-tjetrit (me zor ose me qejf), për Tiranën me lulishte por pa OJQ për mjedisin (të më ndjenjë OJQ-të se nuk e kam me to, madje ato shqytr

që janë), me vajza e djem të veshur me basme dhe pa xhinse, por më të vërtetë dhe më të mirë (ndoshta) nga ipad-istët e sotëm. Tirana ime ke ndryshuar aq shumë sa që edhe në zyrën e adresave po të të kërkjoja nuk do të të gjeja dot. Ti sot ke sheshe me plot emra të huaj, në nder të çdo funksionari shteti që erdhi e do të vijë në vendin tonë. Dhe mirë bëjnë. Po ç'patë moj Tiranë që na hoqe emrin e shkollës "11 janari". Editi ishte zonjë grua, por ne të 11 janarit mbetëm. Pastaj na ndërrovo Dinamon me Selmanin, na vure lloj-lloj emrash që shumë syresh nuk i shqiptojnë dot. Bota e "përjashtme" i ka ruajtur emrat e patriotëve të vet dhe e ka lënë qytetin të zbkurohet. Përse e mundojmë përditë kaq shumë qytetin tonë? Tirana nuk mban më. E në vend që Shqipëria të mësonte nga Tirana, Tirana ka mbyllur gojën përpara Shqipërisë...

ALGEN NIKOLLA:

DETAJET
E DASMËS
MADHESHTORE
TE VALERIA
MARINIT



MIRELA MILORI

Lë Zërin e
Amerikës për
ABC News



WWW.SHQIPTARJA.COM

Suplementi i së shtunës te SHQIPTARJA.com

THASH&THEM

VITI II NR. 18 E shtunë, 11-05-2013

E-mail: thashethem@shqiptaria.com



REZARTA SHKURTA

Tregon barkun në muajin e katërt të shtatzanisë

E lumtur, artistja e njohur si këngëtare,
modele dhe fotografe këto kohë është
shkëputur disi nga jeta artistike duke iu
përkushtuar shtatzanisë së saj

INTERVISTA


Teksti nuk lidhet
me jetën private

Albërie Hadërgjonaj: Për këngën “më ndanë” nga burri

BB6,
Joana:
Rikja është
lesbique



Këngëtarja e njohur në këtë intervistë rrëfen për pjesëmarrjen e saj në Top-Fest dhe për tekstin e këngës, i cili nuk lidhet me asnjë histori të jetës së saj private



JONIDA HITOVEZI

Albërie Hadërgjonaj është një nga këngëtalet më të mira të skenës sonë. Përherë e freskët, rinore aq sa duket sikur vitet nuk kanë ecur për të, ajo di të vijë tek publiku gjithmonë ndryshe, duke i përshtatur tregut dhe trendeve të reja. Këtë herë ajo vjen me një këngë mjaft të bukur, me tekst të Olti Currit. "Asnjëherë" është kënga që tashmë shihet si pretendente për çmimin e madh të festivalit të muzikës moderne shqiptare Top-Fest 10. Albëria në këtë intervistë tregon përse e pranoi këtë baladë dhe thashethemet që "gojë e liga" siç i quan ajo janë hapur nisur nga kënga, e cila është një baladë dashurie.

Albërie kënga juaj në top-fest ka pasur një sukses mjaft të madh. Përse erdhët me një baladë?

Baladat janë këngët që mua më pëlqejnë më shumë dhe ndjehem mirë, sepse karakteri im i vokalitet mirë më mirë në balada!

Duket se jeni një ndër favoritet për të qenë fituesja e këtij kompeticioni, çfarë mendon se e bën të veçantë këtë këngë?

Kënga për mua është emocion dhe nëse të godet atëherë është sukses i padiskutueshëm. Të jem e sinqertë kur e kam dëgjuar si demo, na emocionoi dhe menjëherë u futa për të kënduar; për të parë dhe për të krijuar idenë se a bën apo s'bën për mua. Unë thjesht me lalalala dhe nga krahu tjetër po shikoja sy me lotë dhe thash "ok that's my song"!

E ndjeni se mund të jeni ju ajo që do të rrëmbejë çmimin e parë?

Unë u rrita në festivale dhe kompeticione. Unë ndjej vetëm që këngën e duan dhe jam e bindur që do të jetojë aq sa njerëzit, do të dashurojnë dhe do të zhgënjehen! Do ta mirëpres sido që të jetë, sepse gjithmonë në "Top-fest fiton ajo që e ka merituar.

Çmimi i parë në një festival të muzikës moderne shqiptare, çfarë do të përfaqësonte për ju?

Po është vlerësim dhe sigurisht që ndjehesh mirë për diçka që ke investuar shpirtin, emocionet etj, po për mua ato çmime kanë një vlerë që se përshkruaj dot.. Më e vogla p.sh: sa herë kam miq të rinj të ftuar në shtëpi u tregoj me krenari trofet e mia. Jam me fat, sepse kam punuar me më të mirët ndër vite..I falenderoj nga zemra!

Thashethemet për divorcin

Albërie Hadërgjonaj: "Kënga u bë shkak i ndarjes"

Jeta ime private është vetëm e imja. Thashethemet si ndalojmë dot!



"Asnjëherë", kujt i drejtohet Albëria?

Olti Currin pyete më mirë për tekstin (qesh).E falenderoj nga zemra për fjalët se më ka nxjer-

rë punë tani, veç kanë filluar thashethemet.

Në këngë ka shumë nota nostalgjike, ju vetë a jeni nos-

talgjike për diçka?

Po jam shumë edhe më së miri e transmetoj në këngë më duket.

Albërie, së fundmi ka shumë thashetheme se martesja juaj me Mentorin është në krizë. A ka ndonjë të vërtetë në këto fjalë?

Është folur shumë rreth martesës dhe divorcit. Njerëzit flasin dhe mua sinqerisht nuk më sjell asgjë më të qenit në gojë e liga.

Jam munduar gjithmonë të jem e sinqertë dhe të flas, por besoj që unë duhet të flas vetëm për arritjet e mia profesionale. Jeta ime private është vetëm e imja. Thashethemet si ndalojmë dot!

Sa e lumtur jeni si nëna e Anxhelinës dhe Agnesës?

Jam mami më e lumtur në botë. Janë vajza shumë të mbara dhe i falenderoj nga zemra që nuk u mërzitën kurrë nga këshillat e mia, ndonjëherë edhe të tepruara!

Anxhelina tashmë është në një lidhje. Je e kënaqur me zgjedhjen që ajo ka bërë?

Janë vajza me gjithë të mirat! E, si mund të ndodhte ndryshe për Anxelinën. Ata të dy janë të mrekullueshëm dhe kënaqem kur i shoh të lumtur! Për mua kjo ka rëndësi; lumturia e vajzës sime!

Një duet mes jush kur do të vijë?

Sapo ka dalë në treg një duet me një këngëtarë nga Kosova. Është këngë komerciale por shumë "in" me shijet e momentit.

Planet e kësaj vere cilat janë?

Ufff... Verën e kam të mbyllur me punë dhe s'kam as edhe një natë të lirë. Faleminderit për intervistën. Faleminderit ty që po e lexon tani!



Algen Nikolla duket se ka qenë një ndër njerëzit kryesorë që është kujdesur për mjaft detaje të dasmës.



Ceremonia

Algen Nikolla: Detajet e dasmës madhështore të Valeria Marinit

Olen Çezari i ftuar special për të luajtur muzikë në kokteilin e dasmës

JONIDA HITOVEZI

Dasma e Valeria Marinit ka pasur jehonë të jashtëzakonshme në vendin fqinj, por është diskutuar e komentuar shumë edhe në Shqipëri. Dikur një nga femrat më seksi të Italisë, Valeria ka ditur parësisht viteve të mbetet në një formë të shkëlqyer. Javën e kaluar, pikërisht më 5 maj ajo është martuar në një ceremoni madhështore me biznesmenin italian Giovanni Cottone. Ajo që na ka bërë përshtypje kanë qenë personazhet shqiptarë që kanë qenë prezentë në këtë ceremoni. Algen Nikolla duket se ka qenë një ndër njerëzit kryesorë që është kujdesur për mjaft detaje të dasmës. Një tjetër shqiptar ka qenë edhe violinist i njohur Olen Cesari, i cili me orekstrën e tij ka luajtur muzikë gjatë kokteilit. Më shumë se çfarë ka ndodhur dhe disa detaje pikante, i mësoni në këtë intervistë të shkurtër me djalin e njohur shqiptar, Algen Nikolla, i cili është ndër të paktët persoanzhe shqiptar që ka qenë afër shumë VIP-ave botëror për shkak të punës së tij.

Algen, cili ishte roli yt në dasmen super të "blinduar" të Valeria Marinit?

Roli im ishte supervisor në organizimin dhe akomodimin e të ftuarëve, në logjistikën e spostimit nga "Basilika Ara-coeli" tek "Villa Piccolomini" dhe të dispozitivit të sigurisë. 60 bodyguard ishin tek Basilica, ndërsa tek vila ishin 18 për

shkak se është pronë private dhe e rrethuar.

Pse u komentua kaq shumë kjo dasmë?

E bëri të komentuar pompoziteti që ishte më i madh edhe sesa martesat e Tom Cruise, sepse celebrimi u bë në "Campidoglio". Plus kësaj kishte një numër të madh të ftuarish, rreth 750. U komentua shumë për ceremoninë e darkës, në kishë ishte kori gregorian dhe 20 violina e organistë. Plus bllokimi total i sheshit Venezia ku kishte njerëz që prisnin që në mëngjes tek shkallët e Campidolios. Pastaj kjo dasmë sigurisht do të kishte një vëmendje të veçantë pasi Valeria është një personazh shumë i njohur në botën e shoubizit italian. Një detaj tjetër interesant ishte edhe fakti që për fustanin e dasmës ishte bërë një konkurs me fansat e saj në Twitter.

Çfarë të bëri përshtypje nga detajet?

Festa ishte e fantastike, madhështore pa asnjë dyshim. Tek Villa Piccolomini të ftuarit sapo zbrisnin, kishin Gipsy Kings e Mariachi që i prisnin me serenata. Interesant ishte fakti që kokteili u mbulua komplet nga violinisti shqiptar Olen Cesari dhe Orkestra e tij, për të vazhduar më pas me Gigi d'Alesion, Ana Tatangelon live, Craig David e me vonë në diskotekë me DJ Fargetta. Pastaj diçka e bukur ishte se çifti në vend të dhuratave u kërkoi donacion për një repart pediatrie e më shumë e mbledhur u blenë një skaner dhe një sallë operacioni.



NË FOTO: (Lart) Olen Çezari dhe Algen Nikolla (Majtas) Algen Nikolla me Craig David (Djathtas) foto nga ceremonia private e Valerias




ERMAL MAMAQI Tani humorin e sjell me muzikë!

Ermal Mamaqi ka sjellë së fundmi klipin e tij më të ri në bashkëpunim me Dr. Florin "Do të vij të dielën". Klipi deri tani është pritur mjaft mirë nga fansat dhe nga Shqipëria e Mesme ku ishin fokusuar vitin e kaluar me "Ku ka si Tirona", tani dy këngëtarët kanë zbritur më në jug duke sjellë traditën polifonike më "in" aq më tepër që tani është një peniidhë dasmash. Madje shumë shpejt

pritet që ata të dy të bëjnë një këngë me motive nga veriu i Shqipërisë. Xhirimet e klipit janë bërë në fshatin Vuno dhe në të shihet Ermali në rolin e djallit të dashuruar, ndërsa Bora Zemani në rolin e vajzës, e cila duhet të marrë leje nga familja për të takuar djalin. Madje pa u martuar as një puthje nuk mund të shkëmbejnë me njëri-tjetrin. Ndërkohë këngëtarit dhe aktori, Mamaqi së fundmi ka hapur

edhe një studio produksioni në të cilën bashkëpunon me Dr. Florin, Edlir Begollin, Pirro Çakon etj. Ajo që vihet re dhe që kemi mësuar është se Ermali edhe pse ka ikur nga Apartamenti 2XL do të vazhdojë të bëjë humor, por jo në skenë por me anë të klipëve të tij. Këtë ai e ka shprehur shpesh edhe me shaka në tavolina me miqtë e tij, se humorin mund ta sjell po aq mirë në klipe sa edhe në skenë. Ndërsa karriera po shkon më së miri, e tillë është edhe jeta private e Ermalit. Ai shumë shpejt pritet të bëhet baba dhe të dy me Amin janë mjaft të lumtur për këtë ndryshim të rëndësishëm që po ndodh në jetën e tyre.





PAPARACI

Albana & Olti dhe kombinim perfekt edhe jashtë studios

Të dy i shohim çdo të dielë në ekranin e Top-Channel në emisionin "Fan's club" duke komentuar gjithçka që ndodh me banorët e "Big Brother", me familjarët e tyre dhe me vëmendjen e madhe që shtypi ka ndaj këtij realiti shou. Prezantuesja e suksesshme dhe opinionisti e tekstshkruesi i shumë këngëve hit Olti Curri janë kapur nga paparaci ynë duke shijuar një kafe në një nga lokalet e kryeqytetit. Siç shihet në foto, dy personazhet e njohur duken të relaksuar e pa "etheet" që kapin thuasje gjithë publikun nga ngjarjet që ndodhin në BB6. Madje sikur ta kishin lënë me fjalë, të dy si ngjyrë kryesore në veshjet e tyre kishin zgjedhur ngjyrën blu!



REZARTA SHKURTA



Tregon barkun në muajin e katërt të shtatzënisë

Rezarta Shkurta tashmë ka hyrë në muajin e katërt të shtatzënisë. E lumtur, artistja e njohur si këngëtare, modele dhe fotografe këto kohë është shkëputur nga disa nga jeta artistike duke iu përkushtuar shtatzënisë së saj. Plot entuziazëm e jetë, Rezarta shfaqet edhe në këtë foto ku barku tashmë i duket qartë. Madje mund të themi se ajo duket mjaft bukur dhe rrumbullakosja e barkut i shkon shumë. Në daljet e saj të pakta këto kohë, siç ishte prezenca në 1 vjetorin e djalit të Ingrid Gjonit, Shkurta rrezaton e gjitha nga lumtura. Gëzimi tjetër që ka përjetuar këngëtarja është se bebi që ajo pret është i seksit femër. Rezarta gjithmonë ka thënë

se do të dëshironte shumë të ishte nëna e një vajze dhe tashmë kjo dëshirë është realizuar. "Kjo ishte dëshira ime dhe e Ermalit. Donim shumë që fëmija ynë i parë të ishte vajzë dhe Zoti na e plotësoi dëshirën", - është shprehur ajo. E martuar prej shtatë vitesh me Ermal Hoxhën, këngëtarja 26-vjeçare ka bërë kuriozë shumë njerëz, për faktin pse në jetën e tyre nuk po hynte një fëmijë, meqenëse martesat e tyre prej kohësh ishte konsoliduar. Momenti më i mirë duket se ka qenë këtë fillim viti, ku Rezarta është ndjerë e plotësuar me karrierën e saj dhe ka qenë gati për të provuar ndjesinë e mrekullueshme të të qenit nënë.

PRINC HARRY

Flirt me Bleonën. Këngëtarja, "Është i pashëm dhe i egër"!

Mediat britanike, në veçanti "Daily mail" i ka kushtuar një hapësirë interesante këngëtares shqiptare Bleona Qerreti. Sipas gazetarit që e ka shkruar këtë artikull, Princ Harry-t i sugjerohet që t'i kthejë sytë nga Bleona, pasi ajo është jo vetëm seksi por edhe e çmendur pas

tij. Në shkrim citohen disa nga përgjigjet që Bleona ka dhënë lidhur me Princin duke u shprehur se kanë shumë shoqëri të përbashkët dhe se Harry duhet të jetojë i lirë e të jetë vetvetja. Madje ajo ka shtuar se ai i duket shumë simpatik dhe se ka dëgjuar se është gjithashtu edhe i egër si maskulli.

MIRELA MILORI

Lë Zërin e Amerikës për ABC News

Spikerja e njohur e lajmeve Mirela Milori do të kthehet në Shqipëri, pas eksperiencës së saj disa vjeçare në Zërin e Amerikës. Kështu kemi mësuar nga burime të sigurta, të cilat kanë konfir-

muar se gazetaria tashmë do të jetë pjesë e një ekriani shqiptar. Mësohet se Milori do të kthehet për të qenë spikerja kryesore në "Abc news", pasi më parë, para largimit për në Amerikë ka qenë një nga figurat kryesore lajmeve në ekranin e TV Klan. Kohë më parë në një ng amediati e shkruara lidhur me rikthimin e saj gazetaria ka thënë se: "Rikthimi im në Shqipëri nuk lidhet me çmimin e ofertës që mund të kem! Nuk orientohem nga paga në një ofertë pune! Klima e mirë në ekip dhe profesionalizmi janë dy elementët thelbësorë kur mendoj për ofertat e punës. Paga vjen mbas tyre". Mirela është divorcuar nga bashkëshorti i saj, me të cilin ka edhe një djalë të vogël 7 vjeçar.



Hueyda

Një recetë bukurie kundër kohës!

Ajo ka disa sekrete të vogla, të cilat ka preferuar t'i ndajë me publikun

JONIDA HITOVEZI

Hueyda El Saied pak kohë më parë u rikthye në Tiranë dhe si përherë ka tërhequr vëmendjen me pamjen e saj. E bukur, e freskët dhe mjaft në formë ajo është shfaqur në lokale me miqtë e saj, por edhe në studio të ndryshme televizive. Për këtë ajo ka disa sekrete të vogla, të cilat ka preferuar t'i ndajë me publikun dhe fansat e saj.

Hueyda, kur nisa dita jote?
Në orën 7.

Cili është sporti që bën në mëngjes?
Poer Plate dhe biçikletë.

Çfarë e shoqëron gjithmonë në mëngjesin tënd?
Lëng portokalli – mango, një sallatë frutash dhe një kruasan.

Referon frutat apo menunë tradicionale?
Frutat.


Drekën e ha gjithmonë në orar fikse?
Jo fatqësisht.

Sa kafe pi në ditë?
Një.

Ushqimi që ke mënjauar tërësisht?
Ai me yndyrë. Mendohej të ha sa më pak mish.

Darkën si e mbyll?
Ah këtë po ju a lë ta imagjinoni. (qesh)

Çfarë gatuan gjithë pasion?
Sushi-t.



Hueyda Elsaied

Sa varet lumturia nga ushqimi që dikush konsumon?
Kohët e fundit më pëlqen të gatuj gjëra të veçanta dhe jo vetëm për veten dhe kjo më gëzon.

Pija që të sjell gjithmonë në qejf?
Champanja.

Në një natë melankolike, cila do ishte menuja jote?
Kur jam melankolike nuk kam uri.

Me ëmbëlsirat si i ke raportet?
Për fat, nuk ka shumë ëmbëlsira që më pëlqejnë.

Çfarë të mban gjithnjë në formë të shkëlqyer?
Dashuria. (qesh)

Këshilla më e mirë që do i jepje një mikeje për linjat e saj?
Të mos darkoj dhe pse unë s'kam arritur ende ta bëj një gjë të tillë.

JOANA- ANAIDIT: "Mos ndërhyj në lojën time"

Joana del në kopsht me Edberin dhe Viganin, ndërkohë që më vonë me ta bashkohet edhe Anaidi. Ai e pyet Joanën se përse duket e nervozuar, ndërkohë që Joana ia tregon me detaje të gjithë debatin dhe se si filloi gjithçka. Ndërsa Joana tregon për debatin, Anaidi i kujton diçka që i ka bërë përshytyje tek ajo para disa minutash, ku e ka thërritur lirin me një term përkrahës "zemër". Ai e pyet se çfarë kërkon të arrijë me atë që bën, pasi e di shumë mirë se çfarë mendimi ka liri për të. "Ti shiko shpirtit e zemrat e tua, kur i thërrit Elonës", ia kthen Joana. Ndërsa Anaidi i thotë se ai po i bën për një arsye të gjitha dhe duket se po ia amin qëllimit. "Po ti ku e di arsyen pse ia thashë unë?", e pyet Joana, ndërsa i thotë se ai ia ka përmendur këtë gjë enkas për ta bërë të ndihet keq dhe të duket keq përballë




të tjerëve. "As se çfarë bëj unë me lojën time, është puna ime", shprehet Joana. Kjo gjë e mërzit Anaidin, i cili çohet nga tavolina dhe i thotë se kjo do të jetë hera e fundit që diskuton me të për lojën. "Hajt, suksese", ia kthen Joana. Ajo më vonë e diskuton këtë gjë me Edberin dhe Viganin, duke

JOANA: Rikja është lesbike, në Facebook foto vetëm me vajza

Vigani dhe Edberi ndodhen në dhomë me Joanën dhe të tre secili shtrirë në krevatin e vet, fillojnë të bisedojnë. Dy djemtë kanë dyshime se Rikja është banorë e infiltruar dhe i kërkojnë edhe Joanës mendim rreth dyshimeve të tyre. Ndërsa Joana ka një tjetër dyshim për Riken. Edberi e pyet për këtë dyshim, pasi ajo këtë gjë e ka diskutuar edhe me Anaidin gjatë ditës. Joana fillon të tregojë dyshimet që ka për Riken se mund të jetë lesbike, edhe pse thotë që nuk duhet të flasë për jetën private të saj. Djemtë e pyesin nëse jo mund t'ia përdorë këtë gjë gjatë lojës dhe e pyesin se sa e sigurt është për këtë që thotë. Joana shpreh shumë siguri për vërtetësinë e këtij fakti dhe thotë se në "Facebook" mund të arrihet të mësohet shumë të vërteta dhe tregon gjithashtu se di çdo gjë nga e përditshmja e saj. Joana tregon se për Riken di shumë gjëra të cilat banorët nuk i dinë ende. Ajo thotë se Rikja nuk ka aq shumë miq sa thotë se ka dhe se nuk ka udhëtuar aq shumë, siç tregon.

"Nuk ka punuar në një firmë të njohur, siç thotë", tregon Joana e gjithashtu komenton veshjet e saj, të cilat nuk janë të shtrenjta, ashtu siç tregon Rikja. Joana tregon se Rikja ka shumë foto me vajza në faqen e saj në rrjetin social "Facebook". Ndërsa më vonë flasin për jetën e natës dhe mentalitetin në Kosovë, i cili sipas djemve, është ndryshe nga mentaliteti në Shqipëri. Më pas ata ndërrtojnë bisedë, duke komentuar atë që janë duke bërë banorët e tjerë në dhomën e ndenjes. Ndërkohë, dëgjojnë zërat e banorëve të tjerë që shkojnë në dhomën tjetër të gjumit dhe komentojnë Elonën. Joana është e sigurt



që Elona do të hyjë në dhomën e tyre dhe do t'i vijë inat që Edberi ka vendosur të flejë në dhomë me ta. Ajo qesh me të madhe dhe përmend emrin e Edberit, duke thënë se këtë gjë po e bën për lojë kundër Elonës. Ndërsa Elona nuk shkon aty, dhe të tre banorët vazhdojnë të shkëmbejnë biseda të përgjithshme mes tyre.

ERMELA: Nuk mund të krahasohem me Joanën



Ermela Mezuraj, e vetmja fituese femër e pesë edicioneve të kaluara të Big Brother, e ftuar në Fan's club ka dhënë opinionin e saj për lojën e banorëve. Një nga pyetjet që i është bërë Ermelës ka qenë edhe ajo se si e komenton faktin që Anaidi i ka thënë Joanës se ka të njëjtën pëlqyeshmëri me Ermelën në publik. "Joana përpiqet të bëjë shou, po kjo nuk do të thotë se ka inteligjencën e duhur sa të krijohet një strategji dhe pa strategji aty brenda je i fikur. Është e ekzagjeruar si natyrë, me aq sa unë kuptoj. Dhe nëse do e përkufizojva vetëm me një fjalë Joanën do ishte: femra që s'do doja kurrë ta kisha për shoqe", -ka thënë ajo, teksa ka shtuar se krahasimi mes saj dhe Joanës nga ana e Anaidit nuk ka vend dhe nuk qëndron.

Vila 12
KARAOKE NIGHT
LOUNGE BAR
RRUGA "MUSTAFA MATOHITI", PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA
Cel. 0696070651



In Memoriam

PËRKUJTOHET deputeti i shquar i Shkodrës, Prof. Kolë Prela, në 65-vjetorin e flijimit për fjalën e lirë. Po të ishte si Kaç Islami do vdiste në shtrat me gjoksin plot dekorata. Idealisti që u sakrifkua për aspiratat tona europiane të perealizuara akoma

Kolë Prela, deputeti historik, ende pa varr në Shkodër

Si u pushkatua opozitari i parë në Parlamentin e '46-s


■ ■ ■ **TIRANE**

PRELË MILANI

Deputeti historik i Shkodrës, Kolë Prela, u flijua 65 vjet më parë për fjalën e lirë. Ndaj vendosa të bëjë këtë kujtesë historike me rastin e 65-vjetorit të pushkatimit. Profesor Kolë Prela është opozitari i parë që kërkoi hapur pluralizmin politik, në Parlamentin famëkeq të 1946-ës, por ai u dënua me vdekje si tradhtar i popullit. Ai ishte doktor i lauruar në Torino, studiues, publicist dhe kritik arti. Ishte antifashist i vjetër, krijues i Këshillit Krahinor të NÇL të Shkodrës. Ishte organizatori i Lëvizjes Antifashiste në Rrethin e Dukagjinit dhe i ngritjes së Batalionit "Perlat Rexhepi". Profesor Prela ishte edhe një arsimtar i shquar, ku ka qenë Drejtor i Normales së Elbasanit dhe Profesor i Liceut të Shtetit Shkodër. Ky idealist i shkëlqyer, u pushkatua për aspiratat tona europiane të perealizuara akoma. Ai u pushkatua në lule të rinisë duke u shuar dhe si familje. Prof. Kolë Prela është antipod i deputetëve të sotëm që shiten e blihen si lopët në treg. Ky emër ia vlen të kujtohet sot me nderimin më të madh si model engjëllor i idealizmit të shqelmuar e baltosur nga demagogët e paskrupull të pushtetit.

FAMILJA MARTIRE E KOLË PRELËS NË SHEKUJ

Profesor Kolë Prela lindi në Shosh, më 19 tetor 1916 në një trung të vjetër atdhetarësh të martirizuar (Lulash Bala i internuar dhe i pushkatuar nga turqit në Torobullus, Mark Milani, luftarë kundër turqve e malazezëve në vitet 1910, 1911, 1915, u martirizua si Fanolist dhe është një nga martirët e besës shqiptare, pasi shkoi në litër vetëm për të mos shkelë besën që i kishte dhënë shokut të prangave Zef Delia). Serbo-malazezet gjatë Luftës së Parë Botërore, babait të Kolë Prelës i dogjën shtëpinë, prandaj detyrohet të shpërngulet në qytetin e Shkodrës së bashku me familjen e djalin e mitur. Në vitet 1923-1928 Kol Prela vazhdoi Kolegjin Saverjne, nxënësi i Mjedës e përfundon kolegjin duke marrë pikët maksimale. Nga viti 1929-1936 përfundon shkëlqyeshëm Liceun e Shtetit "28 Nëntori", pastaj përfiton të drejtë studimi në Itali dhe në vitet 1936-1940, përfundon Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë në UT të Torinos duke u lauruar Doktor i Shkencave letrare. Nga viti 1940 deri në qershor 1943 ka punuar si profesor i Letërsisë, Latinishtes dhe Greqishtes së Vjetër



Letra e deputetit historik të Shkodrës Profesor Kolë Prelës, drejtuar Mehmet Shehut më 1946-n

Martirizimi

Profesor Kolë Prela u arrestua me 14 shtator 1946. U akuzua se ka qenë anëtarë i Komitetit Qendror të Parisë Demokratike dhe në bashkëpunim me organizatën terroriste të Klerit Katolik ka luftuar për përmbytjen e pushtetit popullor në Shqipëri. Për të gjitha këto dënohet me vdekje si tradhtar i popullit më 13 prill të vitit 1948, pushkatohet në livadhe të Shkodrës, nuk dihet se ku i përfundoi trupi, pasi akoma edhe sot nuk ka varr.

në Liceun e shtetit "28 Nëntori" Shkodër. Ka qenë koleg dhe mik i Skënder Luarasit, Gaspër Palit, Qemal Draçinit, Ernest Koliqit, Gjergj Kokoshit, Simon Rrotës,

Zef Kolombit, Ndue Përlucës, Safet Butkës. U shqua si mësimdhënësi, metodist, përkthyes, publicist dhe kritik arti. Ka qenë Drejtor i Normales së Elbasanit, ka bashkëpunu-

ar me revistat "Hylli i Dritës", Leka, "Zani Shnanout", "Fryma" Cirka, "Kumbona e së Dielës", "Tomorri" etj. Ka shkruar shumë artikuj studimorë si "Shqyppja Ilire", "Tokë e madhnume", "Nacionalizma shqiptare", "Dom Ndre Mjeda dhe klerikët", "Çështje filozofike". Çështje e të mësuarit", "Mbi njohjen e botës", "Rrymat e jetës shoqërore", "A është Mjeda liriku më i madh i Shqipërisë", "Gjuha e Fishtës" etj. Artisti i Popullit Çesk Zadeja, Profesorët Shefik Osmani, Çun Jonuzi, Androkl Kostallari, heronjt e popullit Tomë Kola, Nazmi Rushiti, Bardhok Biba, intelektualët Lorenç Shiroka, Luigj Sheldia, Angelin Zojzi, Caf Jonuzi, Gjovalin Çerkaxhia, Jorgji Sota, Tonin Kiri, Çesk Bazhdari etj, kanë qenë disa nga ish nxënësit e Kolë Prelës. Profesor Prela ka qenë një nga organizatorët e demonstratës antifashiste të 22 shkurtit të vitit 1942. Ai ishte një nga nationalistët e parë independent që përqafoi plat-

formën politike të Konferencës së Pezës, hyri në FNÇ dhe së bashku me Riza Danin, Dom Luigj Picin, Xhemal Brojën, Rexhep Hakën, Sadik Bekteshin, Shyqyri Hafizin, formuan Këshillin e parë Krahinor Nacionalçlirimtar të Qarkut të Shkodrës me në krye major Sabri Gjonin. Profesor Kolë Prela në qershor vitit 1943 doli ilegal në malet e Dukagjinit për të organizuar lëvizjen antifashiste, atje ngriti Çetën partizane territoriale të Dukagjinit, koordinoi veprimtarinë antifashiste me Shkodrës-Dukagjinit dhe Malësisë së Gjakovës. Në dimrin e vitit 1943 strehoi në Dukagjin dhe siguroi kalimin e Batalionit Perlat Rexhepi në sektorin Bogë-Thethë-Vuthaj. Ishte largpamësia e Profesorit, toleranca dhe dialogu që bëri me grupacionet e tjera politike që gjatë kohës së Luftës nuk pati as një konflikt të përgjakshëm në Dukagjin mes forcave të Frontit nga njëra anë dhe ballistëve e zogistëve nga ana tjetër.

Pushkatimi

Deputeti Prela votoi kundër Kushtetutës së '46-s

Arrestohet në '46-n dhe pushkatohet në '48-n. U akuzua se bashkëpunoi me klerin katolik

■ ■ ■ **TIRANE**



Prof. Kolë Prela

Në zgjedhjet e vitit 1945 zgjidhet deputet i zonës nr. 11 në Nënprefekturën e Dukagjinit, Kolë Prela e Riza Dani ishin deputet i vetëm nacionalist dhe nga opozitarët e parë të Shkodrës së bashku me Hysen Pejën dhe Zef Haxhinë në Kuvendin e parë pas Luftës së Dytë Botërore, ku kërkoi ndërprejren e terrorit politik. Në Asamblenë Kushtetuese kërkoi hapur pluralizmin politik e ideologjik dhe orientimin për perëndimor të Shqipërisë. Kundërshtoi projektin e Kushtetutës së vitit 1946

dhe votoi kundër saj, duke e quajtur si një akt plot ngjyra ideologjike si politikisht ashtu edhe nga pikëpamja social politike. Demokracia e lirë që kërkoi në deputetët Riza Dani, Kolë Prela, Hysni Peja, etj, nuk është veçse demokracia borgjeze shkruan gazeta "Bashkimi" më 17 mars 1946. Profesor Kolë Prela u arrestua me 14 shtator 1946. U akuzua se ka qenë anëtarë i Komitetit Qendror të Parisë Demokratike dhe në bashkëpunim me organizatën terroriste të Klerit Katolik ka luftuar për përmbytjen e pushtetit popullor në Shqipëri. Për të gjitha këto dënohet me

vdekje si tradhtar i popullit më 13 prill të vitit 1948, pushkatohet në livadhe të Shkodrës, nuk dihet se ku i përfundoi trupi, pasi akoma edhe sot nuk ka varr. Prof Kolë Prela ishte një idealist i shkëlqyer që për aspiratën tonë historike evropiane të perealizuara akoma u pushkatua ne lule të rinisë duke shkrimatur si person dhe si familje. Ai është Antipod i deputetëve të sotëm që shiten e blihen si lopët në treg. Ky emër ia vlen të kujtohet sot me nderimin më të madh si model engjëllor i idealizmit të shqelmuar e baltosur nga demagogët e paskrupull të pushtetit.



NË FOTO: Paulin Fausti, Pater Gjon Shllaku, Danjel Dajani në gjyqin para pushkatimit, në vitin 1948

PROF. PRELA është antipod i deputetëve të sotëm që shiten e blihen si lopët në treg. Ky emër ia vlen të kujtohet sot si model engjëllor i idealizmit të shqelmuar e baltosur nga demagogët e paskrupullt të pushtetit

DËNOHET me vdekje si tradhtar i popullit më 13 prill të vitit 1948, pushkatohet në livadhe të Shkodrës, nuk dihet se ku i përfundoi trupi, pasi akoma edhe sot nuk ka varr.



Deklarata

Pater Gjon Shllaku kontribuoi në kulturë, nuk është fashist

■ ■ ■ TIRANE

PRELË MILANI

Kësaj deklarate të bujshme, pas viteve nëntëdhjetë i janë referuar disa autorë. At Danjel Gjecaj tek libri "Martirët e Kishës Katolike 1944", Ahmet Bushati tek libri i tij "Në gjurmët e një ditari", Zef Simoni tek "Gjenocidi komunist në Shqipëri", Fritz Radovani tek libri "Një monument nën dhe", At Zef Pëllumbi tek libri "Rrno për me tregue". Këtë fakt në mënyrë demaskuese e ka cituar gazeta "Koha e re" qysh me 26 janar të vitit 1946. Angjelin Zojzi në Gazetën "Shkodra", i pranishëm në atë séance gjyqësore shkruan: "Siç në fillim të vitit 1946, filozofi Gjon



Pater Gjon Shllaku

Shllaku ndersa po zhvillonte mësim u arrestua me akuzë "tentativë për ikje". Kjo akuzë e gënjeshtërt tron-

diti mikun e tij Prof Kolë Prelën që ishte deputet. Kjo lëshoi dritë mbi fatin e ardhshëm të intelektualëve shkodranë, prandaj doli me forcë dhe guxim në mbrojtje të tij duke lëshuar një deklaratë të befasishme përpara trupit gjyqës. Gjyqi po zhvillohej në Kinemanë "Rozafat" me altoporlante në rrugë. Kryetari i trupit gjyqës e lexoi me zemërim e nervozizëm këtë deklaratë duke shtuar se ky person sikur të ishte trim le të vinte këtu dhe të deklaronte hapur. Profesor Kolë Prela që rastësisht ndodhej në rrugë, erdhi e u fut menjëherë me kokën lart drejt e në sallën e gjyqit. Shoku kryetar i séancës, erdha të mbroj deklaratën që sapo lexuat. Atë deklaratë e kam lëshuar unë dhe jam i vendosur të mbroj të vertetën.

Dy deklarata historike të profesor Kolë Prelës, shkëputur nga Dosja 2293 e AQSHF

Letra e drejtuar Mehmet Shehut

"Ndërpre operacionin e dhunshëm në Dukagjin. Operacini i Ndrekorinos ka ngjallur tmerr. Për një fishek, për një allti, nuk mbeti njeri pa u vra ose burgosë në gjithë Dukagjinin"

■ ■ ■ TIRANE

Fort i nderuemi Gjeneral!
Jam i detyruem t'u informoj në mënyrë të menjëhershme pasi mvartësi juaj Ndrekorino në Rrethin e Dukagjinit, ka filluar një operacion represiv, krejt të panevojshëm dhe ma do mendja i pa autorizuar të përdori dhunë ushtarake pa ditë me ba dallim mes të fajshmit dhe të pafajshmit. Si Përfaqësues i Dekretuem në Asamblenë Kushtetuese i zgjedhur nga zgjedhist e kësaj zone dhe organizator i lëvizjes nacionalçlirimtare nga fillimi e deri sot, deklaroj se lëvizjes sonë askurrkush në Dukagjin nuk ju kundërvu me armë. Madje as tani nuk paraqitet asnjë rrezik për një gja të të kësaj natyre. Operacioni i Ndrekorinos ka ngjallur tmerr, paknaqësi, e pasiguri, njerzit nga friga po arratisën e marrin malin, jo për t'u bashkuar me reaksionarët të cilët nuk e di se ekzistojnë por për hirë të së vertetës duhet thanë se ne po i krijojmë me duart tona. Po të arrestojmë e pushkatojmë për një fishek, për një pushkë, për një allti nuk mbetet njeri pa u vra ose burgosë në gjithë Dukagjinin. Malsori ma parë pranon vdekjen se sa hunin e pa kursim që po i epet për shpinë. Si deputet i kësaj zone, unë hy dorzanë për të dorzue të gjithë të frigsuemit e të pa qartsuemit, me kusht që të lihen të lirë të shkojnë në shtëpitë e tyre pasi nuk kam ba asnjë veprë kriminale



Kolë Prela duke dëshmuar në Gjyqin e Pater Gjon Shllaku

as ndaj qerverisë as ndaj Luftës Antifashiste.

V.F.L.P

Me nderime e konsideratë të lartë

deputeti i Dukagjinit Profesor Kolë Prela.d.v.

Kodër Shëngjergj 25.12.1945.

Dosja 2293 Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme Tiranë.

Deklaratë në mbrojtje të Patër Gjon Shllakut dhe grupit të klerikëve të Shkodrës më 1946

Unë i nënshkruemi Kol Prela, profesor në liceun e shtetit Shkodër dhe Përfaqësues i Dekretuem në Asamblenë Kushtetuese, përta i perket të pandehurit Patër Gjon Shllaku, Françeskan nga Shkodra

dekleroj sa më poshtë vijon.

P.Gjon Shllakun e kam noftë për herë të parë në verën e vjetit 1940, kur u ktheva prej Italisë për mbarrim studimit e larta.

Qysh në takimet e para që kam pasë me të, kam mujtë me konstatare se ai ishte një element anti-italjan dhe anti-fashist.

Kudo që kishte rastin e mundësinë, demaskonte dhe disaprovonte ardhjen e Italisë këtu të najtën gja bante edhe me përkrashitë e Italisë e me tradhëtarët vazhdimisht ktu. Ka qënë kundër artikullit denigrues për popullin shqiptarë, që P.Fuly Cordignano pat botue në revistën "Albania. Madje, në këtë rastin e fundit nuk u kondenu vetëm me dizaprove, por edhe punoi për përpilimin e broshures "Cordignano", "Një gjyq

përpara botës", tue gjetë gati gjithë bibliografinë, tue përkthye gjithë copat e autorëve gjerman, që nevojiteshin

Argumenti

Operacioni i Ndrekorinos ka ngjallur tmerr, paknaqësi, e pasiguri, njerzit nga friga po arratisën e marrin malin, jo për t'u bashkuar me reaksionarët të cilët nuk e di se ekzistojnë por për hirë të së vertetës duhet thanë se ne po i krijojmë me duart tona

NË NUMRIN E NESËRM DO TË LEXOINI:

Si e sfidoi kryetarin e Gjyqit Komunist Prof. Kolë Prela. Çfarë tha në Asamblenë Kushtetuese për të mbrojtur Pater Gjon Shllakun. Replikat me përfaqësuesin e KQ të Tiranës Abdyl Kokoshin. Akuzat për lidhjet me anglo-amerikanët. Pushkatimi jo si të tjerët në Zallin e Kirit. Arsyet pse ia fshihën varrin pas pushkatimit lidhur dorë për dorë me mikun e tij avokatit e mirënjohur Paulin Faustin.

për atë përgjigje. Nuk e vuni emrin në fund mbasi broshura dilte në emën të grupit të profesorëve të Liceut të Shtetit Shkodër e ne emën edhe ky, do të dukej, se profesorët e një instituti shqiptar, mos të ishin në gjendje me shkrujt një artikull, pa kërkuë ndihmën nga jashtë rrethit të tyre. Këtë, mund ta dëshmojnë edhe profesorët Mark Ndoja dhe Simon Deda, të cilët në atë kohë kanë qënë në kontakt të vazhdueshëm me të pa ndehurin. Këtë qëndrim anti-fashist ka vazhduë ta mbajë gjatë gjithë kohës që kam qënë në kontakt deri në qershor 1943 datë në të cilën jam ilegalizue, mbas të cilës nuk kam pasë rast me ra në përpjekje me të derisa asht çlirue Shqipnia. Mbas çlirimit, dihet prej të gjithëve, se P. Gjoni, ka dhanë kontribut në lamën ku ashtë ma i përgatitun d.m.th në atë të kulturës. Ka ba konferencën për inagurimin e Shtëpisë së Kulturës në Shkodër, në të cilën ka thanë këto fjalë: Ashtë hera e parë që Shqipnia çlirohet me gjakun e bijve të vet. Independenca e Shqipnisë sot nuk asht një dhunti, por asht fryt i përpjekjeve të popullit shqiptar". Përmbajtjen e kësaj deklarate, jam gati me vërtetue edhe përpara Gjyqit të Popullit

V.F.L.P.

Shkodër, 14.02.1949. Dekleruesi Profesor Kolë Prela d.v.

Fridz Radovani "Një monument nën dhe" De angelës .Zagreb 2004, fq 101.

Marrë nga Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

debati

REAGIMI I DREJTORIT Jam i bindur se përçarja e alkolike e këtij idividuali është pasioni i tij i pabazë për t'u servilosur me shpresën e "llokmës pasqjehore" siç e thotë ai ndaj "kushos" së tij të pretenduar.

ZHANI CIKO:

Nuk ka presione politike ndaj artistëve

"TKOB prej dhjetë vitesh ka eliminuar rastet e persekutimit shpirtëror apo administrativ të artistëve"



Drejtori i TOB, Zhan Ciko

■■■ TIRANE

Dirigjenti Edmond Doko denoncoi dy ditë më parë se artistët e Teatrit të Operas janë nën presion politik. Administrata e këtij teatri ka mbledhur të dhënat personale për të gjithë artistët, emër, mbiemër, atësi, adresat e shtëpisë dhe numrat e telefonit.

Në denoncimin e tij Doko thotë se këto të dhëna janë dërguar në zyrat elektorale të Partisë Demokratike dhe artistëve ju bëhet presion të japin votën e tyre për të ruajtur vendin e punës.

Pas botimit të këtij denoncimi në Shqiptarja.com, ka reaguar menjëherë drejtori i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit Zhan Ciko, reagim që është publikuar menjëherë në fasqen online të Shqiptarja.com. Përgjigjia e drejtorit të TKOB ciko, ka provokuar një tjetër reagim nga dirigjenti Edmond Doko. Gazeta sjell sot të dy reagimet e tyre të plota.

ZHANI CIKO

"Edmond Doko i cili për të gjithë ata që s'ia kanë dëgjuar emrin ndonjëherë i sapokthyer nga Korfuzi ku festoi familjarisht Pashkët, për çudi pa shkelur ende në institucion për të na sjellë së paku një vezë të kuqe korfiate dha një intervistë të përçarur në gazetën tuaj. Asgjë e vërtetë për presione dhe kërkim vote nga unë apo stafi i T.K.O.B.A.P. Asnjë takim i organizuar me drejtues të PD-së apo politikane të tjerë. Asnjë..... etj, etj.

Njerëzit e T.K.O.B.A.P janë në punë të angazhuar maksimalisht, kanë dhënë deri tani maksimumin e prodhimit artistik. Mundi di vetëm 3 të tjerat pasi seç ndodh në opera nuk e

ka ditur kurrë. Ai është i angazhuar në të tjera probleme! Vetëm për këto katër muaj janë "Gala e hapjes 2013", "Tosca", "Traviata" (balet risi), "Ali Pasca von Janina" (premiere boter-

ore), "Historia e nje kenge". Këto e të tjera përgatitje si Koncerti me rastin e Ditës së Europës, opera "Don Giovanni", baleti "Enderr e një nate vere", "Kumbimi i zemres came", "Aida" në përgatitje paralele. Shtu këtu dhe një seri koncertesh në holl, skenë dhe jashtë T.K.O.B., ku artistët që punojnë tek ne dhe stafi nuk po gjejnë kohë të "thashethemiohen nga ethet e atyre që vuajnë".

T.K.O.B prej dhjetë vitesh ka eliminuar rastet e persekutimit shpirtëror apo administrativ të artistëve apo punonjësve të administratës.

T.K.O.B merr pjesë në këtë fushatë kombëtare zgjedhore përmes punës dhe krijtarisë mobilizuese dhe rezultative. T.K.O.B.A.P është në rrugën e duhur në sajë të vizionit që ka dhe në sajë të punës që shpallos dhe nuk ka nevojë të bëjë elozhe për suksesin e merituar.

Për të gjitha forcat politike, për mbarëvajtjen e fushatës ne kemi krijuar kushte të shkëlqyera duke kordinuar me korrektësi maksimale dhe pa asnjë dallim dispozitën tonë



Fushata

T.K.O.B merr pjesë në këtë fushatë kombëtare zgjedhore përmes punës dhe krijtarisë mobilizuese dhe rezultative. T.K.O.B.A.P është në rrugën e duhur në sajë të vizionit që ka dhe në sajë të punës që shpallos dhe nuk ka nevojë të bëjë elozhe për suksesin e merituar.

për zhvillimin e suksesshëm të veprimtarive. Mesazhe të shumta, sms falenderimesh dhe konsideratë maksimale i disponojmë për kënaqësinë tonë nga organizatorët.

Më shumë se një shtytje e posaçme jam i bindur se përçarja e alkolike e këtij idividuali është pasioni i tij i pabazë për t'u servilosur me shpresën e "llokmës pasqjehore" siç e thotë ai ndaj "kushos" së tij të pretenduar. Por llokma do t'i mbesë në fyt nga secili krah apo nxitësit e tij, pasi shembulli i perkushtimit dhe lealitetit është më i vërtetë dhe bindës së doktrat e këtij sharlantani".

Tenori

Agim Hushi, teknika e tij e të kënduarit e mrekullueshme

Mediat ndërkombëtare shkruajnë për albumin më të ri të tenorit shqiptar

ELMAR LEIMGRUBER

Agim Hushi, tenori i jashtëzakonshëm shqiptar me famë në skenat botërore, njëkohësisht profesor i Kantos në Konservatorin e Vjenës ka publikuar së fundmi një CD Solo, të cilën do ta konsideroja një kryevepër të madhe muzikale. Është kënaqësi e veçantë të dëgjosh zërin e tij, më të veçantë sot në botë, që me këngë si "Un Amore così Grande" prek zemrën e çdo dëgjuesi.

Nuk më mbetet gjë tjetër të them veçse: Teknika e tij e të kënduarit është e mrekullueshme dhe pres me padurim të marr pjesë në një koncert të tij të madh, recital operistik, këtu në Vjenë.

Njëkohësisht në CD do të gjeni edhe 18 këngë të kënduara në stilin Belcanto, me mjeshtri të atillë që

zëri i tij unik, i rrallë, të dalë mbi nivelin e shoqërimit të orkestrës "New Europe Symphony", nën dirigjimin e shkëlqyer të Andrija Pavlic.

Midis kryeveprave botërore, si "O sole mio", "Granada", "Ti voglio tanto bene", "Passione", "Voce e Notte" dhe "Un amore così grande", gjendet edhe një kompozim i shkëlqyer i vetë Agim Hushit "Këngët e natës". Në dallim nga tenorë të tjerë, ndoshta më të njohur, por sipas këndvështrimit tim më pak të talentuar se ai, Agim Hushi nuk vjen nga një Casting Show, por në të vërtetë është një gjigand i fushës së muzikës. Këngëtar lirik dhe pedagog: pas diplomimit në degët Letërsi dhe Psikologji, Hushi ndjek pasionin e tij, studimet në Akademinë e Arteve në Tiranë ku diplomohet me rezultate të shkëlqyera në vitin 1991. Jo me kot, menjëherë pas përfundimit të studimeve në vitet 1991-1992 atij i behohen rolet kryesore në operat "Tosca", "Cavalleria Rusticana" dhe



Tenori Agim Hushi

"Il Trovatore", të vëna në skenë nga Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit. Dhe jo vetëm kaq, në Akademinë e Muzikës në Budapest ai specializohet në lëndën e pedagogjisë muzikore, ku spikat dhe arrin përsëri të marrë rolet kryesore në operat "Manon Lescaut", "Turandot", "Il Tabarro". Ne

1997 Agim Hushi fillon karrierën e tij në Australi, fillimisht në Operën e Adelaides ku debutoi me rolin e Des Grieux në veprën "Manon Lescaut" nën dirigjimin e Maestro Richard Bonynge. Pas kësaj eksperience, që rezultoi të jetë tepër e suksesshme, Hushi angazhohet menjëherë në Operën e Sydney-it ku me të njëjtin rol u prit me shumë entuziazëm, si nga publiku, ashtu edhe nga kritikët, të cilët e krahasuan me tenorin legjendar Beniamino Gigli. Në 1999 Agim Hushi i akordohet një bursë nga qeveria Australiane, e cila i jep mundësi të rritet akoma më shumë profesionalisht duke ndjekur studimet pasuniversitare Master në Milano me Franco Corelli. Fondazione Australian Jane Potter e nderon Hushin me 1999 me çmimin kryesor për Performancë të Spikatur në fushën e Muzikës Klasike. Një vit më vonë, Kryeministri Australian e shpall "Artistin e vitit 2000". Agim Hushin mund ta dëgjoni gjithashtu

ne CD e publikuar ne 2010 "Il Bel Sogno", krah sopranos së mirënjohur Inva Mula dhe Orkestrës Filarmonike të Zagrebit. Ai ka përforcuar në skenat operistike më të spikatura të botës, mes të cilave në Australi, Neu Zeland, USA, Malajzi, Brunei, Singapor, Dubai, Hungari, Gjermani, Rusi, Slloveni, Maqedoni, Kosove, Kroaci, Çeki, Rumani, Bullgari, Francë, Greqi, Qipro, Danimarkë, Itali, Spanjë, Angli, Zvicër, Austri, si edhe në vendlindjen e tij, Shqipëri.

Hushi është themelues i Belcantos në Adelaide të Australisë, ka qenë për disa vite pedagog në Universitetin Shtetëror të Singaporit. Në shumë universitete të shquara ne rang botëror si "Santa Cecilia" Rome, apo "Ecole Normale de Paris", ai ka drejtuar një numër Klasash Masteri. Prej disa vitesh, Agim Hushi është pedagog i Kantos në Konservatorin e Vjenës.

(Marrë nga redakteur.cc. Përktheu nga gjermanishtja, Megy Ton)



Teatri i Operas dhe Baletit

REPLIKA E DIRIGJENTIT

Doko: Denoncimi nuk solli debat, Ciko vetëm fyen

“Mungon debati që do të rriste presionin ndaj politikës e qeverive”

Fill pas botimit në faqen online të reagimit të drejtorit të TKOB Zhani Ciko, dirigjenti Edmond Doko shprehet se ndjehet i fyer. Ai ka sjellë në redaksi një replikë të shkurtër, të cilën po e botojmë si më poshtë.

EDMOND DOKO

Ndej keqardhje për fjalorin fyes dhe për të pavërtetat sidomos të paragrafit të fundit në reagimin e botuar në Shqiptarja.com online të drejtorit të TKOB Zhani Ciko.

Sa për institucionin dhe arritjet e tij nuk më takon dhe rezervohem të bëj komente. Vlerësimin dhe kritikën e vërtetë e bëjnë publiku dhe kritika e specializuar dhe jo drejtorët, qofshin këta dhe artistë. Sa për politizimin e institucionit dhe polarizimin e tij faktet flasin ndryshe. Megjithatë denoncimi im nuk pretendon lëndë, dhe kurrësi nuk ka gjë personale me drejtuesin “mitik” të TKOB apo më saktë të vetëmitizuar



Dirigjenti Edmond Doko

dhe as nuk pretendon “llokma paszgedhore” siç shprehet në mënyrë cinike në prononcimin e tij “ditirambik” e të

mbushur me shpifje pas denoncimit tim të dy-tre ditëve më parë në gazetën tuaj, por përkundrazi; hartuesi i këtij shkrimi është i përgjegjshëm e timid në rolin e tij, aspak i përcartur e alkolik!!!, siç paturpësisht më cilëson në shpifjen e tij sharlataneske në Shqiptarja.com ky drejtues, i cili jo sinqerisht dhe cekët arsyeton e gjykon. Do të isha i kënaqur nëse denoncimi do të provokonte debat demokratik, publik, debat që ka munguar dhe është i haruar ndër vite të largët, me pjesmarje sa më të gjerë, debat që në vijim do të shërbente në mirëritje të presionit lobues ndaj politikës e qeverisë(ve) për nevojën e fitimit të pavaresisë politike të TKOB, si një institucion artistik e parametrevë evropiane, me vlera kapitale për artin e kulturën kombëtare.

Por më duhet të pohoj se drejtuesi i TKOB e vetëpersonalizoi debatin duke me fyer me fjale që si shkojnë për shtat një njeriu normal e jo me nje drejtuesi “mitik”. Më e rëndësishme për mua personalish, në këtë histori është që të mos çehohet liria. Artistet e kanë të shenjtë këtë standart

Auron Tare

Pas 23 qershorit s’do të njihet asnjë konçension ndaj Monumenteve

Deputeti i PS-së Auron Tare ka reaguar dje mbi dhënien me qira të monumenteve të kulturës. “Me gjithë përpjekjet e Shoqërisë civile dhe specialistëve të fushës për ta ndaluar këtë veprim jo logjik dhe shumë të dëmshëm për trashëgiminë kulturore, është publikuar tashmë në fletoren zyrtare vendimi i cili do ta radhisë Ministrin e Kulturës dhe vetë Kryeministrin në ikje, në rreshtin e atentatorëve ndaj Trashëgimisë Kulturore.”, tha Tare, duke shtuar se akti i kryer vetëm një muaj para ikjes nga pushteti të qeverisë së Berishës, “kërkon t’u japë klientjes të Familjes edhe vlerat e fundit

të pasurive kombëtare. PS, ju bën thirrje të gjithë atyre, që të joshur nga orvatjet e fundit të Qeverisë për të blerë një grusht votash edhe me Monumentet Kombëtare, se pas fitores...nuk do të njihim asnjë Marrëveshje të lidhur në dëm të interesave të Trashëgimisë. Ne nuk do t’i njohim askujt, asnjë koncesion, qiramarrje apo forme tjetër ndaj Monumenteve të Kulturës. Pas 23 Qershorit ne do të bëjmë të mundur që të gjitha Monumentet tona të Kulturës, jo vetëm të mbrohen dhe të restaurohen, por edhe të vihen në shërbim të turizmit kulturor dhe në dobi të komuniteteve kudo që ato ndodhen.



Auron Tare

Koment

“Amore Grande”, Agim Hushi tenori i sfidës



NGA ANILA BASHA

Nuk mund të kishte asnjë dyshim se Agim Hushi në publikimin e CD së tij “Amore Grande” do të kishte një sukses të padiskutueshëm. Në fakt, më duket se një zë potent dhe i fortë shqiptar si ai i Agim Hushit, nuk mundet asesi të ishte i “bojkotuar” në cd makinash, apo në kompjuterat tanë të punës. Agim Hushin e kam dëgjuar në sallën e Pallatit të Kongreseve dhe më duket se zëri i fortë që buçiste në sallë, nuk vinte vetëm nga skena dhe nga ai vetë që këndonte mbi plate. Sot që kujtohem se më duhet të bëj një krahasim, duket sikur shihje një film në HD, ku ti vetë ndihesh se je i përfshirë apo je protagonist i skenave. Sikur e këndoja unë vetë, këtë përshtypje më linte zëri i tenorit. Më pas e njoha nga afër dhe e takova vitin e kaluar, kur tenori Hushi mori titullin Qytetar Nderi i Kavajës, qyteti nga ai ka prejardhjen. Mora ftesën për të dëgjuar koncertin e tij recital me miqtë në qendër të Kavajës dhe këtë ftesë e prita disi me dyshim mes paragjykimesh se një koncert operistik i një tenori nuk mund të realizohet në shesh të qytetit, e për më tepër, të mblidheshin me mijëra vetë.


Sërisht së dyti, mendimet e mia më dështuan sepse sheshi ishte plot, dhe qytetarët e Kavajës qëndruan në këmbë për më shumë se dy orë për të parë spektaklin recital që Hushi u dhuroi.

Supriza e tretë është albumi “Amore Grande”. Duke e imagjinuar në salla të mëdha, se mendoja dot se realizimi i disa prej veprave me famë botërore, do të vinte me aq potencë edhe nëpërmjet CD-së “Amore Grande”. Zëri që vjen nga CD nuk ka asnjë ndryshim nga zëri që vjen prej sallave të mëdha, dhe kjo, edhe për shkak të studios që e ka regjistruar këtë album. Zëri vjen i fuqishëm, i plotë, plot ulje ngritje sipas këngëve që në të 18 pjesët e tyre të krijuar idenë se nuk kanë një fund, por do të vazhdojnë të sinkronizuar njëra me tjetrën, që albumi të mos mbarojë. Është një zë i pjekur, që nuk të jep më përshtypjen, por që është se vërtetë, se gjendet në kulmin e shpërthimit të tij vokal e profesional.

Albumi i ri i tenorit të krijon ndjesinë e shplohjes, qetësisë, kthjelltësisë, dëshirës për të jetuar, për ta dëgjuar e ridëgjuar disa herë e pse jo, të krenohesh që tenori shqiptar ka arritur një sukses të tillë me albumin, jo vetëm në Vjenë, aty ku u prodhua, por edhe jashtë Austrisë. Sigurisht, nuk mund të mohohet se një ndihmë të çmuar, shumë të madhe, për këtë realizim të shkëlqyer, e ka edhe Neë Europe Symphony Orchestra, ku me një rregjistrim të qartë, mund të dallosh çdo tingull, vegël frymore, që përçohet nëpërmjet albumit sikur të jesh në një sallë gjigande.

Agim Hushi po përgatitet këto kohë për një tur koncertesh në Kinë. Pas sukseseve të njëpasnjëshme në skenat evropiane. Unë nuk e di nëse në Shqipëri ky tenori i madh me këtë zë potent është vlerësuar sa duhet nga organet shtetërore, apo nga publiku. Por që Shqipëria jonë, 22 vite në tranzicion, ka nxjerrë një zë të tillë si ky i tenorit Agim Hushi, na bën të ndihemi më shumë se krenarë për suksesin e këtij albumi dhe të vetë tenorit.

“Amore Grande” do të promovohet jo vetëm në Vjenë, mes tenoreve dhe njerëzve me famë botërore, por shumë shpejt edhe në Nju Jork. Dhe fama e një shqiptari që me artin e zërit të tij potent trondit skenat më të mëdha botërore, na bën të ndihemi të gjithë krenarë. Falemnderit Agim Hushi!



Manchester United

Januzaj fiton 'Topin e Artë', FSHF në sulm

Mesfushori i Manchester United, Adnan Januzaj, është shpallur lojtarit më i mirë i turneut prestigjioz për futbollistë të rinj 'Blue Stars/FIFA Youth Cup'.

lojtarit më të mirë të turneut. Kjo është bërë e ditur edhe në sajtin zyrtar të 'FIFA Youth Cup'.

e pestë, Dortmundi humbi nga Zenit St. Petersburgu me shifrat 1:0. Januzaj që shumë shpejt do të jetë pjesë e ekipit të parë të Manchester United me trajnerin e ri Moyes është një talent që u zbulua nga Alex Ferguson.

vazhdojnë për pajisjen me pasaportë Shqiptare. De Biasi e ka konfirmuar që futbollisti kosovar i pëlqen dhe se do të ishte sukses nëse do të luante me Shqipërinë.

Safet Gjici është shpallur 'Qytetar Nderi' i qytetit

Kukësi në festë FSHF jep trofetë

Skënderbeu do ta marrë kupën në verilindje

Lajmi

Sot në Kukës do të jetë e gjithë Federata Shqiptare e Futbollit për të dorëzuar trofetë e më të mirë këtë edicion të Superligës.

KUKES DYLBER BALLA

Sot do të zhvillohen ndeshjet e fundit të kategorisë superiore, duke mbyllur edhe këtë edicion të kampionatit kombëtar. Sytë e të gjithë sportdashësve do të jenë në Kukës, atje ku vendasit kanë përgatitur një festë të madhe për suksesin që arritën këtë edicion me shpalljen si nënkampion të vendit dhe pjesëmarrjen direkt në Kupat e Evropës.



Çmimi

Bashkia e Kukësit do ti akordoi titullin qytetar nderi presidentit Safet Gjici, pas vendimit që mori dje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me motivacion ngritjen e sportit

Ndeshja e ditës së djeshme mes ekipeve të Lacit dhe Tiranës ka përfunduar në barazim pa gola duke nxjerrë në pah edhe njëherë problemet te Tirana.

ndërsa të tjerët po mendojnë për të ardhmen jashtë Tiranës. Ndërsa ekipi i Lacit ka arritur objektivat me pjesëmarrjen në finalen e Kupës së Shqipërisë këtë edicion përballë ekipit të Bylisit.

Boks

Uldedaj kampioni shqiptar që premtion medalje në botërorin e Kievit

Boksi shqiptar po prodhon një tjetër talent, duke i dhënë me tepër vlerë këtij sporti në vendin tonë. I riu lezhjan Jurgjen Uldedaj është shpallur kampion si boksi-eri më i mirë i vitit për moshën 16 vjeçare në Shkodër.



Jurgjen Uldedaj

perspektivë për të ardhmen. Kampionati botëror është angazhimi i radhës për të riun Uldedaj, i cili do të zhvillohet në Ukrainë.

Të huajt

Gega: S' do pranoja as Messin në kombëtare



Pas lajmeve në media se trajneri i U-19 Skënder Gega i ka bërë ofertë për në kombëtare një futbollistë me origjinë nigeriane që luan te Bylisi, ka reaguar vetë trajneri duke e hedhur poshtë.

LAJME SHKURT

Lamtumira e Ferguson kushton 3 mijë Paund

Uest Bromuich-Manchester United, ndeshje e vlefshme për javën e fundit të Premier League-s, do të luhet më 19 maj në 'The Hawthorns' pritet të ketë me mijëra tifozë të United për ti dhënë 'lamtumirën' Sir Alex-it.

Ronaldo ofendoi stolin e Realit: Vafshi në djall

Cristiano Ronaldo pasi shënoi golin e dytë në ndeshjen që madriënët fituan 6-2 ndaj Malagës u kthye duke ofenduar stolin e Realit në Madridit në mënyrë të cuditshme.


Futbollistët e Milanit në kor: Alegri të qëndrojë

Futbollistët e ekipit të Milanit të gjithë në grup kanë dalë në mbrojtje të trajnerit Alegri duke kërkuar që të qëndrojë në Milano edhe për edicionin tjetër.

PARADE FJALEKRYQESH

INGIA Kadri Vokopola

FJALEKRYQI SPORTIV



HORIZONTAL

- Një pune paguhet.
- Abidal te Barcelona.
- Inicialet e Suarez e bomber.
- Një ekip... anglez.
- Një krye të notarëve.
- Ka rivalë Mesdiasit.
- Skuadër greke.
- Eshtë arma e... skuadrave te catenaccio-s.
- Një biçikletë dyshë.
- Një krye të masave.
- Cash ish-tenist.
- Eshtë prestioni në vena.
- Rrinë në stol me rezervë të tillë.
- Janë të tilla edhe cricket e badminton.
- Rush ish-bomber i Liverpool.
- Një është edhe Michael Phelps.
- Vrapon në hipodrom.
- Kështu thirren lojtarët e Liverpool.


- Ekstre në elemente.
- Kapak pa ekstreme.
- Një pjesë në lojë.
- Janë pikët e fitores.
- Ela e volejbollit.
- Ruan në... kufij.
- Në krye të noterëve.
- Një sport me slalom gjigant.
- Ilir Daja.
- Skuadra merengue.
- Eshtë tokë... buke.
- Kapak pa ekstreme.
- Një pjesë në lojë.
- Janë pikët e fitores.
- Ela e volejbollit.
- Ruan në... kufij.
- Në krye të noterëve.
- Një sport me slalom gjigant.
- Ilir Daja.
- Skuadra merengue.

VERTIKAL

- Një markë motokiclete
- Një pomatë... shëndeti.
- Një pemë e lartë.
- Një pjesë e tematikës.
- Janë të gjitha skuadra.
- Kështu thirret treneri në Itali.
- Eshtë si kumbarrë.
- Fare pa fe.
- Prost profesori i Formula 1.
- Poborsky ish-futbollit çek.
- Në mes të Alessandro dhe Piero.
- Thurman aktore.
- Tri në tetëdhjetë.


- Eshtë tokë... buke.
- Kapak pa ekstreme.
- Një pjesë në lojë.
- Janë pikët e fitores.
- Ela e volejbollit.
- Ruan në... kufij.
- Në krye të noterëve.
- Një sport me slalom gjigant.
- Ilir Daja.
- Skuadra merengue.
- Eshtë tokë... buke.
- Kapak pa ekstreme.
- Një pjesë në lojë.
- Janë pikët e fitores.
- Ela e volejbollit.
- Ruan në... kufij.
- Në krye të noterëve.
- Një sport me slalom gjigant.
- Ilir Daja.
- Skuadra merengue.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT SPORTIV



FJALEKRYQI PA SKEME

DUHET TË NXINI 34 KUTI



HORIZONTAL


- Eshtë pjesë e dramës.
- Një studim shfrytëzohet në arkivat.
- Ndare pa ekstreme.
- Cyeli i Agamemnonit.
- Eshtë vulkan i Antarktidës.
- Argento aktore.
- Janë pjesë për aktorë.
- Një që ka të paktën një prind me ngjyrë.
- Kështë fillon një melodë.
- Eshtë republika në Santo Domingo.
- Ekstre në trap.
- Eshtë gara më e gjatë.
- E famshme ajo e pshërëtimave.
- Martana e Garcia Lorca-s.
- Konak pa kufij.
- Një mund të jetë gotik.
- Ishtin paraardhësit e atzëtkëve.
- Janë bisha... ridens.
- Dy asa.
- Mbyllin një sirtar.
- Ente Zytare Ndërtimi.
- Ato të hebrenjeve janë sinagoga.
- Otto që që piktur.

- Ente Industriale.
- Inicialet e Berg kompozitor.
- Eshtë vend si katarit.
- Inicialet e Asimov.
- Agjenci Transporti Korçë.
- Ka një mangëli i luajturi.
- Duken në fund.
- I vetmi... për orar.
- Qe mbretëri e Pirros.
- Janë stacionet e beduinëve.
- Mund të jenë sigurie.
- Marozzi showgirl italiane.
- Rrjetë në tenis.

- fishekzjarre.
- Një fjalë e rehatshme.
- Fillojnë panikon.
- U rrembye nga Paridi.
- Hasa kornik.
- Ka lindur fëmijë.
- Janë lajmet... e vjetra.
- Gjarpëron në Burrel.
- Nafta e... Shell.
- Grisur... me gur.
- Janë burrat e motrave.
- Jepet për hartim.
- Një çregullim.


- Eshtë e vrara në luftë.
- Skuadër greke.
- Prishin kohën.
- Eshtë impianti hi-fi.
- Institucione Botuese Italiane.
- Në fund të krahut.
- Fillojnë tatëgjëten.
- Mbyllin një dyqan.
- Qe atdheu u Mozart.
- Eshtë motra e nënës.
- Eshtë motra e nënës.
- Inshin mbrojtës të Karilit të Madh.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT PA SKEME




I KRIPTOGRAFUAR

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË



PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR



HOROSKOPI



DASHI
Marrëdhënia në çift do jete me e mirë dhe me fidakuese se kohet e fundit. Do tregoheni shume me te hapur me partnerin dhe do i merrni gjerat me seriozitet. Beqaret do kenë disa takime, por vjet këshillojnë një refleksim te mire para se te marrin vendime.



LUANI
Dita e sotme do jete e mire dhe jo problematike për te dashuruarit. Ngjyrat do rikthehen serish në jeten tuaj. Ajo mund te gërryeje atë pak nga pak dhe gjithcka do marre fund. Beqaret do kenë mundësi te verteta për takime serioze, por duhet ta dine se personat me te cilët do ndeshen mund t'vене ne prova te veshtira.



SHIGJETARI
Jeta ne çift do jete e animuar dhe do iu sjelle kënaqësi te mëdha sot. Do i shtoni dozat e fantazisë dhe originaliteti prandaj do kaloni momente te mrekullueshme se bashku me partnerin. Beqaret nuk duhet te bien ne pesimizëm për faktin se nuk do e gjejnë as sot atë që kërkojnë.



DEMI
Inflenca e Venusit nuk do jete shume pozitive gjate kësaj dite për jetën tuaj sentimentale. Shpeshherë do ndihen te lënë pas dore dhe te vetmuar. Me financat duhet te tregoheni te kujdesshem dhe nuk duhet te shpenzoni pa u menduar.



VRGJËRËSHA
Ju qe jeni ne çift duhet te bëni çmos qe ta largoni sa me pare rutinën nga jeta juaj. Ajo mund ta gërryeje atë pak nga pak dhe gjithcka do marre fund. Beqaret do kenë mundësi te verteta për takime serioze, por duhet ta dine se personat me te cilët do ndeshen mund t'vене ne prova te veshtira.



BRICJAPI
Gjate kësaj dite do e keni me te thjeshte te nuan harmoninë dhe euforinë ne çift. Si iu ashtu edhe ai qe keni ne krah do tregoheni me te hapur dhe te gatshëm te bëni çmos për te marrë vendime. Beqaret do kenë me shume fat gjate mëngjesit dhe mesditës. Shfrytëzoni sa te mundni ketë perudhe kohe.



BINJAKET
Keni shume kohe qe keni një marrëdhënia dhe lidhja juaj është e forte? Aishtë një shtet nuk do keni asgjë për çfarë te qaheni. Nuk keni për te krijuar asnjehërë ndonjë lidhje po vazhduar kështu. Me financat nuk do keni fat prandaj kujdes kur te bëni ndonjë shpenzim.



PESHORJA
Dite e veshtirë kjo e sotmja për gjithë te dashuruarit. Do debatojeni ashpër me atë qe keni ne krah dhe nuk do arrini dot te bëni dakord. Beqaret do kërkojnë gjate ditës personin ideal, por te pakët do jene ata qe do e gjejnë atë. Ne planin financiar situata do filloje te stabilizohet paksa.



UJORI
Jeta ne çift ka rrezik te mos jete ashtu si ju e keni dëshiruar dhe debatet do duket te pafundme. Mوندhuni te mbani përgjegjësi te tuaja. Një person i mrekullueshem do hyje ne jeten e beqareve sot dhe do e ndryshoje tërësisht rrjedhën e jetës.



GAFORRJA
Si iu ashtu edhe partneri juaj do jeni me humor shume te mire sot. Komunikimi do vazhdoje si gjithmonë dhe mund te merrni një vendim shume te rëndësishëm mbi te ardhmen. Kënaqësitë dhe emocionet do jene te shumta.



AKREPI
Disa probleme te vogla ne dukje do sjellin probleme serioze për jetën tuaj ne çift sot. Mوندhuni te mos merrni masa ekstreme, por te bëni çmos te fletë qelësish. Për financat do jete dite përgjigjësisht e mbrojtur dhe jo problematike. Mos merrni vendime impulsive për te bere investime marandëse.



PESHQIT
Dite shume e thjeshte kjo e sotmja për te dashuruarit. Gjithcka do ece sipas parashikimeve dhe nuk do keni për çfarë te qaheni. Beqaret nuk do kënaqen me takimet qe do kryejnë dhe do vazhdojnë te kërkojnë akoma me tepër. Nuk është dita me e favorshme për ju.

SUDOKU



PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR



**LAJME
NGA BOTA**

■ Hoxhaj: Serbia do ta miratojë marrëveshjen

Në takim të radhës mes kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi dhe homologut të tij serb Ivica Dačić duhet të arrihet pajtimi për planin zbatues sa i përket marrëveshjes së arritur më 19 prill në Bruksel. Nëse kjo nuk ndodh, tha ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Enver Hoxhaj, Kosova do të shtrijë autoritetin ligjor dhe kushtetues në veri të vendit. "Është më se e rëndësishme që Serbia të kuptojë se pajtimi rreth planit zbatues dhe, mbi të gjitha, zbatimi i tij, është në interes të saj dhe të rajonit", ka thënë kryediplomati Hoxhaj. Ministri i Jashtëm i Kosovës tha se, "pa zbatimin e marrëveshjes nga ana e Serbisë, ruga e Beogradit drejt BE-së do të mbetet e bllokuar". Sipas tij, vendimtar në hartimin dhe më pas zbatimin e marrëveshjes do të jetë prestioni i BE dhe SHBA.

■ Turqi, shmangjet atentati ndaj patriarkut

Policia turke ka parandaluar një atentat ndaj patriarkut të Stambollit, ka bërë të ditur dje media turke. Plani i atentatit është zbuluar falë një letre anonime, që i është dërguar prokurorit të përgjithshëm të Stambollit. Menjëherë pas sinjalizimit, policia turke ka bërë të mundur arrestimin e një personi, ndërsa dy të tjerë janë ende në kërkim. Të tre personat kishin planifikuar vrasjen e kreut të Kishës Ortodokse më 29 maj, me rastin e 560-vjetorit të pushtimit otoman të Stambollit. Sipas traditës, Stambolli është qendra shpirtërore e botës ortodokse dhe Patriarku i saj Bartolomeu i Parë është kreu i të gjitha kishave ortodokse.

■ Vriten dy bosë të mafias kanadeze në Itali

Një nga bosët e mafies kanadeze dhe një tjetër shtetas po nga Kanadaja janë gjetur të vrarë në Sicili, ka njoftuar policia italiane. Në lidhje me krimin janë arrestuar dy vëllezër sicilianë. Policia bëri të ditur se Juan Ramon Fernandez dhe Fernando Pimentel u qëlluan me rreth 30 plumba, pasi u ishte ngritur një pritë në një zonë rurale në Casteldaccia, në pjesën perëndimore të Sicilisë. Fernandez, me origjinë spanjolle, mendohet se ka qenë një anëtar i rëndësishëm i familjes mafioze Rizzuto në Toronto të Kanadasë.

■ SHBA, ndodh vjedhja më e madhe kibernetike

Zbulohet vjedhja më e madhe bankare përmes sulmit kibernetik në botë. Lajmi është konfirmuar nga autoritetet amerikane, sipas të cilave një rrjet i kimit kibernetik ka grabitur 45 milionë dollarë, duke tërhequr para nga bankomatet në më tepër se 25 vende, si Francë, Gjermani, Britani, Itali, Japoni, Pakistan, Rumani, Rusi, Ukrainë dhe Shtetet e Bashkuara. Sipas prokurorëve amerikanë, operacioni është kryer në dy faza, në dhjetor dhe në shkurt. Autoritetet në SHBA kanë arrestuar shtatë persona, nën akuzat se kanë qenë pjesë e bazës në Nju Jork. Ata akuzohen se kanë tërhequr 2.8 milionë dollarë në më pak se një ditë.

■ Bangladesh, nxirret e gjallë nga rrënojat

17 ditë pas shembjes së ndërtesës në Bangladesh, ku punonin qindra punëtorë, ekipet e shpëtimit kanë arritur të nxjerrin një grua të gjallë nga gërmadhat. Sipas "The Daily Star", gruaja e quajtur Reshma, është në gjendje të rëndë shëndetësore, por fatmirësisht ka arritur t'i mbijetojë tragjedisë që u mori jetën rreth 1 mijë personave. Ajo ka arritur të mbijetojë për 408 orë nën gërmadha falë ushqimeve dhe ujit që ekipet e shpëtimit kishin hedhur nëpër hapësirat e betonit në ditët e para të tragjedisë. Deri tani, janë konfirmuar rreth 1 mijë të vdekur.



Kalo në Abissnet pa ndryshuar numrin dhe përfito avantazhet e telefonisë tonë fikse

▶ 2000 lekë kohë bisedë dhuratë

▶ 0 lekë tarifë fikse mujore

▶ Çmimet deri -70% më lirë

+ 1 muaj internet falas nëse lidh edhe internetin.



www.abissnet.al



tërheqja e parezistueshme e lirisë

• Alba Malltezi
Drejtoresh e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtoresh e Shqiptarja.com

• Edmond Arizaj
Kryeredaktor

• Genc Kondi
Zv.Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena

Aktualitet: Granit Sokolaj
Ekonomia: Genc Kondi
Social: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli

Website: Suela Gera

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
cel: +355696060418
cel: +355696088847

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë